



Plani i Angazhimit të Palëve të Interesuara (PAPI)

**VNMS për Blue 2, Blue 3 dhe Projektimin e Detajuar Inxhinierik për Sistemin e
Ruajtjes së Energjisë me Bateri 10 MW/26.75 MWh dhe 30 MW/80.25 MWh**

Shkurt 2026

Tiranë, Shqipëri

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

TITULLI I PROJEKTIT	Parqet Fotovoltaike Blue 2, Blue 3 dhe Projektimi i Detajuar Inxhinierik për BESS 10 MW/26.75 MWh dhe 30 MW/80.25 MWh
TITULLI I DOKUMENTIT	Plani i Angazhimit të Palëve të Interesuara (I Përditësuar)

RISH.	QËLLIMI I DORËZIMIT	VËREJTJE/ PËRSHKRIM	HARTUESI	DATA
1	Drafti i Raportit PAPI	Shqyrtim i brendshëm	Abkons	02.05.2023
2	Raport i Përditësuar	Shqyrtim i brendshëm	Abkons	12.02.2026
3	Rishikuar pas komenteve të BERZH-it		Abkons	27.04.2026
4				

QËLLIMI PËRFUNDIMTAR I DORËZIMIT

	KONSULENTI			KONTRAKTORI	
	Hartuesi	Kontrolluesi	Miratuesi	Kontrolluar	Miratuar
Emri/ Mbiemri	Violeta Marko				
Nënshkrimi					
Data					
Statusi i Dokumentit					

Përmbajtja

1. Hyrje	8
1.1. Qëllimi i Planit të Angazhimit të Palëve të Interesuara	8
1.2. Përmbledhje e Projekteve	9
1.3. Kuadri Ligjor dhe Rregullator	10
1.4. Parimet e Angazhimit të Palëve të Interesuara	10
1.5. Struktura e Dokumentit	10
2. Standardet Ndërkombëtare të Zbatueshme dhe Kuadri Rregullator Kombëtar	10
2.1. Kërkesat Ndërkombëtare	10
2.2. Kuadri Ligjor Kombëtar	12
2.3. Aplikimi për këtë PAPI	12
2.4. Veprimet Minimale për Arritjen e Përputhshmërisë (Projektet FV dhe BESS)	15
3. Përshkrimi i Projekteve dhe Zona e Ndikimit (AoI)	15
3.1. Përmbledhje e Përgjithshme e Projekteve	15
3.2. Vendndodhja dhe Kushtet Përreth	15
3.3. Zona e Ndikimit të Projektit	22
4. Identifikimi dhe Analiza e Palëve të Interesuara	25
4.1. Qëllimi i Identifikimit të Palëve të Interesuara	25
4.2. Metodologjia për Identifikimin e Palëve të Interesuara	25
4.3. Kategoritë e Palëve të Interesuara	26
4.4. Analiza dhe Prioritizimi i Palëve të Interesuara	32
4.5. Përditësimi i Regjistrit të Palëve të Interesuara	34
5. Programi i Angazhimit të Palëve të Interesuara dhe Metodat e Konsultimit	34
5.1. Objektivat e Programit të Angazhimit të Palëve të Interesuara	34
5.2. Parimet e Angazhimit të Palëve të Interesuara	34
5.3. Konfidencialiteti, Mbrojtja nga Hakmarrja dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale	35
5.4. Qasja e Angazhimit të Palëve të Interesuara sipas Fazës së Projektit	35
5.5. Metodat e Konsultimit	36
5.6. Materialet e Publikimit të Informacionit	37
5.7. Angazhimi me Grupet e Cenueshme	38
5.8. Dokumentimi i Aktiviteteve të Angazhimit	38
5.9. Burimet dhe Përgjegjësitë	38
5.10. Shqyrtimi dhe Përditësimi i Programit të Angazhimit	39
6. Mekanizmat e Ankesave	39
6.1. Mekanizmi i Ankesave për Komunitetin	39
6.2. Mekanizmi i Ankesave të Punonjësve (KMS2)	45

7. Kuadri i Monitorimit dhe Raportimit	47
7.1. Objektivat e Monitorimit dhe Raportimit	47
7.2. Monitorimi i Aktiviteteve të Angazhimit të Palëve të Interesuara	47
7.3. Konfidencialiteti, Privatësia dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale	48
7.4. Treguesit Kryesorë të Performancës	48
7.5. Monitorimi i Ankesave	50
7.6. Raportimi	50
7.7. Shqyrtimi dhe Përditësimi i PAPI-it	51
8. Rolet dhe Përgjegjësitë për Zbatimin	51
8.1. Përmbledhje	51
8.2. Përgjegjësitë e Sponsorit të Projektit	51
8.3. Menaxheri Mjedisor dhe Social	51
8.4. Zyrtari i Lidhjes me Komunitetin	52
8.5. Kontraktorët	52
8.6. Punonjësit dhe Nënkontraktorët	52
8.7. Koordinimi me Autoritetet	52
8.8. Burimet	53
9. Përfundimi dhe Angazhimi ndaj Palëve të Interesuara	53
10. Shtojcat	54
10.1. Shtojca 1. Modeli i Formularit të Ankesave të Komunitetit	55
10.2. Shtojca 2. Modeli i Regjistrimit të Ankesave	60
10.3. Shtojca 3. Modeli i Regjistrimit të Konsultimeve	61
10.4. Shtojca 4. Modeli i Regjistrimit të Palëve të Interesuara	61
10.5. Shtojca 5. Kalendari i Angazhimit të Palëve të Interesuara	62
10.6. Shtojca 6. MEKANIZMI I ANKESAVE TË PUNONJËSVE (GRM)	64
10.7. Shtojca 7. FORMULARI I PARAQITJES SË ANKESAVE TË PUNONJËSVE	66
10.8. Shtojca 8. Modele formale raportimi të hartuara posaçërisht për përfshirje në Raportet Mujore, Tremujore dhe Vjetore të Menaxhimit	69

Figurat

Figura 1 Harta e objekteve Blue 2 dhe Blue 3, dhe e Sistemit të Ruajtjes së Energjisë me Bateri (BESS)	17
Figura 2 Projektet Blue dhe Projekte të tjera në zonë	24
Figura 3 Prioritizimi i palëve të interesuara	33

Tabelat

Tabela 1 Analiza e Mangësive, Politika Mjedisore dhe Sociale e BERZH-it 2024 KMS 10 kundrejt praktikave rregullatore shqiptare	13
---	----

Tabela 2 Kalendar i Zbatimit të PAPI-it – Projektet Blue dhe BESS	20
Tabela 3 Hartëzimi i Palëve të Interesuara	30
Tabela 4 Hartëzimi i Grupeve të Cënueshme	32
Tabela 5 Kalendar i Publikimit të Informacionit	39
Tabela 6 Treguesit Kryesorë të Performancës (KPI)	49

Shkurtime

AC	Rrymë Alternative
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BESS	Sistemi i Ruajtjes së Energjisë me Bateri
DC	Rrymë e Vazhduar
FV/PV	Fotovoltaik (energji diellore)
KMS/ESR	Kërkesa Mjedisore dhe Sociale e BERZH-it
MA/GM	Mekanizmi i Ankesave
MEI	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës
MW	Megavat
NjA	Njësi Administrative
OHL	Linjë ajrore e energjisë elektrike
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
PAPI	Plani i Angazhimit të Palëve të Interesuara
PMS/ESP	Politika Mjedisore dhe Sociale e BERZH-it
SCADA	Sistem i Mbikëqyrjes, Kontrollit dhe Përvetësimit të të Dhënave
SPV	Shoqëri me Qëllim të Veçantë
TAP	Gazsjellësi Trans Adriatik
TKP/KPI	Treguesi Kryesor i Performancës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social

1. Hyrje

Ky dokument përbën Planin e Angazhimit të Palëve të Interesuara (PAPI) për Parqet fotovoltaike Blue 2 dhe Blue 3, si dhe instalimet shoqëruese të Sistemit të Ruajtjes së Energjisë me Bateri (BESS), të cilat po zhvillohen në të njëjtën zonë projekti, në zonën Seman–Sheq Marinas–Topojë të bashkisë Fier, Shqipëri. Duke qenë se projektet ndodhen pranë njëri-tjetrit dhe po zbatohen në kuadër të të njëjtit financim, aktivitetet e angazhimit të palëve të interesuara janë planifikuar dhe po koordinohen në mënyrë të integruar, me qëllim sigurimin e koherencës, efikasitetit dhe qartësisë në komunikimin me komunitetet e prekura dhe palët e tjera të interesuara.

PAPI është përgatitur në përputhje me kërkesat e Politikës Mjedisore dhe Sociale (PMS) të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), tetor 2024, duke iu referuar në veçanti Kërkesës Mjedisore dhe Sociale 10 (KMS 10) për Angazhimin e Palëve të Interesuara. KMS 10 kërkon që zhvilluesit e projektit të identifikojnë dhe analizojnë palët e interesuara, të vënë në dispozicion informacionin përkatës në kohën e duhur, të zhvillojnë konsultime kuptimplota dhe gjithëpërfshirëse, si dhe të krijojnë dhe mbajnë një mekanizëm për trajtimin e ankesave, për të pranuar dhe adresuar shqetësimet e ngritura nga personat e prekur nga projekti dhe nga palët e tjera të interesuara.

Gjithashtu, PAPI përfshin kuadrin ligjor dhe rregullator të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, në veçanti kërkesat që lidhen me informimin dhe konsultimin publik sipas Ligjit nr. 10440/2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, si dhe legjislacionin përkatës dytësor që rregullon pjesëmarrjen e publikut, vënien në dispozicion të informacionit mjedisor dhe konsultimin me komunitetet e prekura gjatë procedurave të vlerësimit mjedisor dhe të pajisjes me leje.

Ky PAPI përcakton procedurat dhe metodat që do të zbatohen për identifikimin e palëve të interesuara, vënien në dispozicion të informacionit dhe realizimin e aktiviteteve të angazhimit gjatë gjithë ciklit jetësor të projekteve, duke përfshirë fazat para ndërtimit, të ndërtimit, të operimit dhe të çmontimit. Plani përcakton gjithashtu kuadrin për komunikimin e vazhdueshëm, dokumentimin e aktiviteteve të angazhimit dhe rishikimin periodik, me qëllim që angazhimi i palëve të interesuara të mbetet efektiv dhe në përpjesëtim me natyrën dhe shkallën e projekteve, si dhe me rreziqet dhe ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale që lidhen me to..

1.1. Qëllimi i Planit të Angazhimit të Palëve të Interesuara

Projektet ndodhen brenda së njëjtës zonë gjeografike dhe karakterizohen nga kushte të ngjashme mjedisore dhe sociale, si dhe kanë një grup të përbashkët palësh të interesuara, duke përfshirë përdoruesit e tokave në afërsi me zonën e projektit, autoritetet lokale dhe operatorët e infrastrukturës. Përfshirja e Blue 2, Blue 3 dhe instalimeve shoqëruese BESS në një PAPI të vetëm siguron që:

- identifikimi i palëve të interesuara dhe aktivitetet e angazhimit të koordinohen;
- vënia në dispozicion e informacionit të jetë e njëtrajtshme për të gjitha projektet;
- shqetësimet e mundshme me karakter kumulativ, të ngritura nga palët e interesuara, të trajtohen në mënyrë të integruar; dhe
- procedurat për menaxhimin e ankesave të zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme për të gjithë komponentët e projekteve.

Qëllimi i këtij PAPI është:

- të sigurojë vënien në dispozicion, në kohën e duhur, në mënyrë transparente dhe të përshtatshme me kontekstin kulturor, të informacionit lidhur me Projektin;

- të përcaktojë një qasje sistematike për angazhimin dhe konsultimin me palët e interesuara;
- të identifikojë palët e interesuara dhe të kuptojë interesat, pritshmëritë dhe shqetësimet e tyre;
- të nxisë marrëdhënie konstruktive dhe të përgjegjshme me komunitetet e prekura nga Projekti dhe me palët e tjera të interesuara;
- t'u ofrojë palëve të interesuara mënyra të aksesueshme dhe efektive për të paraqitur shqetësime dhe ankesa; dhe
- të mbështesë menaxhimin e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale përmes dialogut të vazhdueshëm.

Për qëllimet e angazhimit të palëve të interesuara, çështjet kryesore që pritet të jenë me interes përfshijnë:

- trafikun e lidhur me punimet e ndërtimit dhe shqetësimet e përkohshme;
- mundësitë e punësimit;
- përdorimin e tokës dhe aksesin;
- ndikimet vizuale;
- zhurmën gjatë fazës së ndërtimit;
- shëndetin dhe sigurinë e komunitetit;
- mekanizmin e ankesave dhe kanalet e komunikimit; dhe
- ndikimet gjatë fazës së operimit, të cilat pritet të jenë të kufizuara dhe të lokalizuara.

Angazhimi i palëve të interesuara konsiderohet një proces i vazhdueshëm, i cili do të vijojë gjatë gjithë ciklit jetësor të Projektit.

1.2. Përmbledhje e Projekteve

Projektet e përfshira në këtë Plan të Angazhimit të Palëve të Interesuara (PAPI) përfshijnë zhvillimin e dy centraleve fotovoltaike (FV), Blue 2 dhe Blue 3, së bashku me një instalimet e Sistemit të Ruajtjes së Energjisë me Bateri (BESS), të gjitha të vendosura brenda së njëjtës zonë projekti, në Njësinë Administrative Topojë të Bashkisë Fier.

Këto instalime janë planifikuar si pjesë e një zhvillimi të integruar të energjisë së rinovueshme dhe do të jenë të ndërlidhura teknikisht përmes infrastrukturës së përbashkët elektrike, duke përfshirë nënstationet dhe sistemet e lidhjes me rrjetin elektrik. Megjithatë do të zbatohen si komponentë të veçantë, centralet dhe instalimet BESS do të funksionojnë në mënyrë të koordinuar dhe, për këtë arsye, trajtohen së bashku për qëllimet e angazhimit të palëve të interesuara dhe të vlerësimit mjedisor dhe social.

Projekti synon:

- të rrisë prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme;
- të mbështesë diversifikimin e miksit energjetik të Shqipërisë;
- të përmirësojë stabilitetin e rrjetit elektrik përmes kapacitetit të ruajtjes së energjisë;
- të kontribuojë në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë; dhe
- të mbështesë objektivat kombëtare në fushën e energjisë dhe klimës.

Zonat e përzgjedhura ndodhen në toka me produktivitet të ulët bujqësor, kryesisht të pakultivuara ose djerrë, dhe janë zgjedhur me qëllim minimizimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale, duke shmangur, për aq sa është praktikisht e mundur, zonat e banuara, habitatet e ndjeshme dhe zonat e mbrojtura.

1.3. Kuadri Ligjor dhe Rregullator

Ky Plan i Angazhimit të Palëve të Interesuara (PAPI) është përgatitur në përputhje me:

- Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it (tetor 2024).
- Legjislacionin kombëtar të zbatueshëm të Shqipërisë lidhur me vlerësimin mjedisor, konsultimin publik dhe publikimin e informacionit.
- Praktikën e mira ndërkombëtare për angazhimin e palëve të interesuara në projektet e infrastrukturës dhe energjisë.

1.4. Parimet e Angazhimit të Palëve të Interesuara

Aktivitetet e angazhimit të palëve të interesuara për Projektin do të udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:

- Transparencë dhe llogaridhënie në komunikim.
- Publikim i informacionit në kohë dhe në formë të aksesueshme.
- Përfshirje dhe mosdiskriminim.
- Konsiderim i grupeve të cenueshme ose në disavantazh.
- Komunikim i dyanshëm dhe reagim ndaj vërejtjeve të palëve të interesuara.
- Dokumentim dhe monitorim i aktiviteteve të angazhimit.

1.5. Struktura e Dokumentit

Ky Plan i Angazhimit të Palëve të Interesuara është strukturuar si më poshtë:

- Standardet Ndërkombëtare të Zbatueshme dhe Kuadri Rregullator Kombëtar;
- Përshkrimi i Projektit dhe Zona e Ndikimit;
- Identifikimi dhe Analiza e Palëve të Interesuara;
- Programi i Angazhimit të Palëve të Interesuara dhe Metodën e Konsultimit;
- Mekanizmi i Ankesave;
- Kuadri për Monitorimin dhe Raportimin;
- Rolet dhe Përgjegjësitë për Zbatimin.

2. Standardet Ndërkombëtare të Zbatueshme dhe Kuadri Rregullator Kombëtar

2.1. Kërkesat Ndërkombëtare

PAPI është zhvilluar në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it (tetor 2024) dhe Kërkesat përkatëse Mjedisore dhe Sociale (KMS), në veçanti:

- Kërkesa Mjedisore dhe Sociale (KMS) 10: Angazhimi i Palëve të Interesuara, kërkon identifikimin e palëve të interesuara, vënien në dispozicion në kohë të informacionit përkatës të projektit, konsultim domethënës, angazhim gjithëpërfshirës të grupeve të cënueshme ose në disavantazh, krijimin e një mekanizmi ankesash dhe angazhim të vazhdueshëm gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit.
- Kërkesa Mjedisore dhe Sociale (KMS) 1: Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rreziqeve dhe Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale, kërkon që angazhimi i palëve të interesuara të integrohet në procesin e vlerësimit mjedisor dhe social dhe në sistemet e menaxhimit mjedisor dhe social.
- Kërkesa Mjedisore dhe Sociale (KMS) 5: Marrja e tokës, kufizimet në përdorimin e tokës dhe zhvendosja e pavullnetshme. KMS 5 është vlerësuar e zbatueshme për Projektin, pasi toka e nevojshme për zhvillimin e centralit fotovoltaik është siguruar përmes një kombinimi të blerjes së tokave private dhe marrëveshjeve të qirasë. Në përputhje me kërkesat e KMS 5 dhe bazuar në verifikimet kadastrale, vërtetimet në terren dhe konsultimet me palët e interesuara, është konfirmuar se nuk ka pasur zhvendosje fizike dhe nuk është identifikuar ndonjë zhvendosje ekonomike. Parcelat e siguruara për Projektin ishin kryesisht toka të degraduara, të pakultivuara ose djerrë dhe nuk shfrytëzoheshin në mënyrë aktive për bujqësi, kryesisht për shkak të mungesës së ujitjes së mjaftueshme dhe kripëzimit të tokës. Aktivitetet bujqësore në zonat përreth, si dhe rrugët ekzistuese të aksesit, mbeten të paprekura. Transaksionet me pronarët privatë të tokave janë kryer mbi baza vullnetare, ndërsa dhënia me qira e tokës në pronësi të bashkisë është formalizuar nëpërmjet procedurave përkatëse administrative. Duke qenë se nuk është identifikuar zhvendosje fizike dhe ndikimet ekonomike janë të kufizuara, kërkesat e KMS 5 trajtohen nëpërmjet dokumentimit të proceseve të sigurimit të tokës, angazhimit të palëve të interesuara dhe krijimit të një mekanizmi për trajtimin e ankesave. Për rrjedhojë, nuk konsiderohet e nevojshme përgatitja e një Plani Veprimi për Zhvendosjen apo e një Plani për Rikthimin e Mjeteve të Jetesës. Në këtë kontekst, rreziku i përgjithshëm që lidhet me marrjen dhe përdorimin e tokës vlerësohet i ulët, ndërsa përputhshmëria me kërkesat e KMS 5 sigurohet nëpërmjet masave të monitorimit të zbatuara si pjesë e sistemit të menaxhimit mjedisor dhe social të Projektit.
- Kërkesa Mjedisore dhe Sociale KMS 4: Shëndeti, Siguria në punë dhe Siguria fizike. Transporti i materialeve dhe pajisjeve do të kryhet përgjatë rrugëve publike ekzistuese, përfshirë segmente ku përgjatë aksit kryesor rrugor ndodhen receptorë të ndjeshëm, si shkolla, banesa dhe zona rezidenciale, objekte dhe hapësira të përdorimit komunitar, si dhe subjekte të tjera që mund të jenë veçanërisht të ndjeshme ndaj trafikut, zhurmës, pluhurit dhe shqetësimeve të përkohshme. Rreziqet e mundshme për shëndetin dhe sigurinë e komunitetit mund të përfshijnë rritjen e trafikut, zhurmën, pluhurin dhe shqetësime të përkohshme. Në përputhje me KMS 4, palët e interesuara të vendosura përgjatë rrugëve të transportit, përfshirë banorët, përfaqësuesit e shkollave dhe institucioneve komunitare, subjektet tregtare dhe autoritetet lokale, do të informohen paraprakisht, sipas rastit, për aktivitetet e transportit. Çdo shqetësim që lidhet me sigurinë rrugore, trafikun ose ndikimet e përkohshme do të trajtohet nëpërmjet mekanizmit të Projektit për trajtimin e ankesave dhe konsultimeve të vazhdueshme me palët e interesuara.
- Kërkesa Mjedisore dhe Sociale KMS 8: Trashëgimia Kulturore. Aktivitetet e transportit do të zhvillohen përgjatë rrugëve publike ekzistuese, të cilat mund të kalojnë pranë zonave me vlerë kulturore ose historike. Megjithatë nuk parashikohen ndikime të drejtpërdrejta në site të njohura të trashëgimisë kulturore, ekziston një rrezik i mundshëm për shqetësim, dëmtim aksidental ose zbulime të rastësishme gjatë punimeve shoqëruese ose ndërhyrjeve të përkohshme. Në përputhje me KMS 8, palët përkatëse të interesuara, përfshirë autoritetet

lokale dhe, sipas rastit, institucionet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, do të informohen për aktivitetet e Projektit. Gjithashtu, do të zbatohet një procedurë për menaxhimin e zbulimeve të rastësishme. Çdo shqetësim i ngritur nga komunitetet ose autoritetet lidhur me ndikimet e mundshme mbi trashëgiminë kulturore do të trajtohet nëpërmjet procesit të angazhimit të palëve të interesuara dhe mekanizmit të Projektit për trajtimin e ankesave.

2.2. Kuadri Ligjor Kombëtar

Në Shqipëri, angazhimi i palëve të interesuara për projektet që i nënshtrohen Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis (VNM Paraprak) rregullohet kryesisht nga Ligji nr. 10 440/2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, si dhe nga aktet nënligjore për zbatimin e tij, përfshirë VKM-në nr. 686/2015, të ndryshuar, dhe VKM-në nr. 247/2014 për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore.

Në kuadër të procedurës së VNM-së Paraprake, zhvilluesi i projektit duhet të vërë në dispozicion informacionin bazë mbi projektin dhe të njoftojë publikun dhe institucionet përkatëse që në fazat e hershme të procesit të vlerësimit. Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe autoritetet lokale përkatëse e bëjnë informacionin mbi projektin të disponueshëm për shqyrtim, duke u mundësuar palëve të interesuara të paraqesin komente ose vërejtje brenda afatit të përcaktuar për shqyrtim. Bashkitë dhe institucionet e tjera kompetente konsultohen zyrtarisht si pjesë e procesit të vlerësimit dhe mund të japin mendime teknike ose të ngrenë shqetësime në nivel lokal, të cilat duhet të merren në konsideratë gjatë marrjes së vendimit mjedisor.

Megjithëse dëgjesat publike nuk janë në mënyrë sistematike të detyrueshme në kuadër të procedurës së VNM-së Paraprake, autoriteti kompetent mund të kërkojë konsultime shtesë kur natyra e projektit, ndjeshmëria e vendndodhjes ose niveli i interesit publik justifikojnë një angazhim më të gjerë. Komentet dhe vërejtjet e palëve të interesuara, të marra gjatë procesit të shqyrtimit, dokumentohen dhe merren në konsideratë nga autoriteti kompetent gjatë përcaktimit nëse projekti mund të vijojë, nëse kërkon masa shtesë zbutëse ose nëse duhet t’i nënshtrohet procedurës së VNM-së së Thelluar.

Këto kërkesa kombëtare plotësohen, kur është e zbatueshme, nga standardet e huadhënësve ndërkombëtarë, të cilat zakonisht kërkojnë një proces më të strukturuar dhe të vazhdueshëm të angazhimit të palëve të interesuara, duke përfshirë përgatitjen e një Plani të Angazhimit të Palëve të Interesuara (PAPI), vënien e vazhdueshme në dispozicion të informacionit dhe krijimin e një mekanizmi ankesash që funksionon gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit.

2.3. Aplikimi për këtë PAPI

Ky Plan është përgatitur për të përmbushur si kërkesat e BERZH-it, ashtu edhe detyrimet ligjore shqiptare. Në rastet kur ekzistojnë dallime ndërmjet tyre, zbatohet kërkesa më e rreptë, veçanërisht në lidhje me angazhimin e hershëm të palëve të interesuara, konsultimin e vazhdueshëm, përfshirjen e grupeve të cënueshme, dokumentimin e aktiviteteve të angazhimit dhe funksionimin e një mekanizmi ankesash në nivel projekti gjatë gjithë ciklit jetësor të tij.

Tabela më poshtë paraqet një analizë të mangësive, duke krahasuar kërkesat e Politikës Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it (2024), në veçanti Kërkesën Mjedisore dhe Sociale 10 (KMS 10), me kërkesat dhe praktikatat rregullatore aktuale në Shqipëri.

Tabela 1 Analiza e Mangësive, Politika Mjedisore dhe Sociale e BERZH-it 2024 KMS 10 kundrejt praktikave rregullatore shqiptare

Tema	Kërkesa e BERZH (referencë KMS10)	Kërkesa/Praktika Shqiptare (VNM Paraprake)	Mospërputhja e Identifikuar në Raport me Kërkesat e BERZH	Veprime të Nevojshme për Përafrim me KMS10	Statusi
Fusha e angazhimit të palëve të interesuara	Angazhimi duhet të fillojë herët dhe të vazhdojë gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit, në përpjesëtim me rreziqet dhe ndikimet.	Angazhimi i palëve të interesuara ndodh kryesisht gjatë periudhës së njoftimit dhe shqyrtimit të VNM Paraprake; nuk ka kërkesë për angazhim të vazhdueshëm pas lejeve.	Angazhimi sipas procedurave kombëtare është i kufizuar në kohëzgjatje dhe nuk mbulon të gjithë ciklin jetësor të projektit.	Zbatimi i angazhimit gjatë projektimit, ndërtimit dhe operimit, siç përcaktohet në PAPI.	PAPI i përgatitur
Identifikimi i palëve të interesuara	Palët e interesuara duhet të identifikohen dhe dokumentohen në mënyrë sistematike.	Palët e interesuara identifikohen kryesisht përmes procedurave të njoftimit dhe konsultimit me autoritetet lokale gjatë VNM Paraprake.	Identifikimi mund të fokusohet tek institucionet dhe banorët e afërt, me hartëzim ose dokumentim të kufizuar sistematik të palëve të interesuara indirekte.	Mbajtja e një hartëzimi të strukturuar të palëve të interesuara dhe përditësimi periodik i tij.	Hartëzimi i palëve të interesuara i përgatitur dhe i përditësuar
Grupet e cenueshme	Palët e interesuara të cenueshme duhet të identifikohen dhe angazhimi të përshtatet në përputhje me to.	Legjislacioni kombëtar nuk kërkon shprehimisht një vlerësim të cenueshmërisë në procedurat e VNM Paraprake.	Vlerësimi i cenueshmërisë në përgjithësi nuk kryhet, përveçse kur kërkohet nga huadhënësit.	Kryerja e vlerësimit të cenueshmërisë dhe përfshirja e masave të angazhimit të synuar kur është e rëndësishme.	Përfshirë në PAPI dhe VNMS
Plani i Angazhimit të Palëve të Interesuara (PAPI)	PAPI duhet të përgatitet, publikohet dhe përditësohet.	PAPI nuk kërkohet sipas procedurave shqiptare të VNM Paraprake.	Mungesa e një mjeti formal planifikimi angazhimi dhe kuadri monitorimi sipas kërkesave kombëtare.	Mbajtja dhe përditësimi i PAPI në përputhje me kërkesat e KMS10.	PAPI i përgatitur
Publikimi i informacionit	Palët e interesuara duhet të marrin informacion në kohë, të rëndësishëm dhe të kuptueshëm.	Publikimi i raportit të VNM Paraprake dhe i informacionit të projektit përmes AKM-së dhe autoriteteve lokale; informacioni shpesh ka natyrë teknike.	Informacioni nuk paraqitet gjithmonë në formate të arritshme, dhe publikimi proaktiv përtej kërkesave ligjore është i kufizuar.	Sigurimi i përmbledhjeve joteknike dhe materialeve të arritshme komunikimi.	Përgatitur / përditësime të vazhdueshme
Konsultim domethënës	Kërkohet konsultim domethënës dhe dokumentim i vërejtjeve.	Komente publike mund të paraqiten gjatë periudhës së shqyrtimit; dëgjesat publike nuk kërkohen sistematikisht për VNM Paraprake, përveçse kur kërkohen nga autoritetet.	Konsultimi mund të jetë i kufizuar në shtrirje dhe kohëzgjatje, dhe dokumentimi se si vërejtjet ndikojnë në vendimet e projektit nuk kërkohet gjithmonë.	Mbajtja e regjistrit të konsultimeve dhe dokumentimi i përgjigjeve dhe masave zbutëse të miratuara.	Në proces
Mekanizmi i ankesave	Duhet të krijohet dhe të jetë i arritshëm një mekanizëm ankesash në nivel projekti.	Procedurat kombëtare mbështeten kryesisht në mekanizma administrativë ankimi;	Mungesa e një mekanizmi formal ankesash në nivel	Mbajtja e një MA funksional me procedura, afate dhe	MA aktiv

Tema	Kërkesa e BERZH (referencë KMS10)	Kërkesa/Praktika Shqiptare (VNM Paraprake)	Mospërputhja e Identifikuar në Raport me Kërkesat e BERZH	Veprime të Nevojshme për Përafrim me KMS10	Statusi
		MA në nivel projekti nuk kërkohet.	projekti sipas procedurave kombëtare.	mbajtje regjistrash të qarta.	
Mbrojtja nga hakmarrja	Angazhimi duhet të jetë pa detyrim, frikësim ose hakmarrje.	Nuk trajtohet shprehimisht në procedurat e VNM Paraprake.	Nuk ka dispozita formale që trajtojnë konfidencialitetin ose mbrojtjen e ankuesve.	Përfshirja e dispozitave të konfidencialitetit dhe procedurave të sigurta raportimi në PAPI dhe MA.	Përfshirë në PAPI dhe MA
Gjinia dhe përfshirja	Angazhimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të marrë parasysh dimensionin gjinor.	Nuk trajtohet specifikisht në procedurat e VNM Paraprake.	Pjesëmarrja e grave, personave të moshuar dhe grupeve të cënueshme nuk monitorohet apo sigurohet në mënyrë sistematike.	Zbatimi i metodave gjithëpërfshirëse angazhimi dhe monitorimi i pjesëmarrjes kur është e rëndësishme.	Përfshirë në PAPI
Privatësia dhe mbrojtja e të dhënave personale	Të dhënat personale dhe privatësia e palëve të interesuara duhet të mbrohen.	Nuk trajtohet sistematikisht në procedurat e konsultimit.	Procedurat e mbrojtjes së të dhënave për regjistrimet e konsultimit dhe ankesat zakonisht nuk janë të formalizuara.	Zbatimi i procedurave të mbrojtjes së të dhënave për regjistrat e palëve të interesuara dhe MA.	Përfshirë në PAPI dhe MA
Angazhimi gjatë ciklit jetësor dhe raportimi	Kërkohet komunikim dhe raportim i vazhdueshëm gjatë gjithë zbatimit të projektit.	Angazhimi përgjithësisht kufizohet në fazën e marrjes së lejeve sipas procedurave të VNM Paraprake.	Procedurat kombëtare nuk kërkojnë komunikim të vazhdueshëm gjatë ndërtimit ose operimit.	Sigurimi i përditësimeve periodike për palët e interesuara dhe mbajtja e kanaleve të komunikimit gjatë ndërtimit dhe operimit.	SER-të janë siguruar; në vazhdim
Burimet dhe përgjegjësitë	Rolet, përgjegjësitë dhe burimet duhet të përcaktohen qartë.	Përgjegjësitë për angazhimin nuk përcaktohen formalisht në procedurat e VNM Paraprake.	Përgjegjësitë e angazhimit mund të mos jenë të caktuara qartë në nivel projekti.	Mbajtja e roleve të përcaktuara brenda strukturës së menaxhimit mjedisor dhe social dhe caktimi i një Zyrtari të Lidhjes me Komunitetin.	Ekipi mjedisor dhe social i caktuar; CLO i emëruar
Monitorimi i efektivitetit të angazhimit	Aktivitetet e angazhimit duhet të monitorohen dhe vlerësohen.	Nuk kërkohet sipas procedurave kombëtare të VNM Paraprak.	Treguesit e monitorimit dhe vlerësimi i efektivitetit të angazhimit përgjithësisht mungojnë.	Përcaktimi i treguesve të monitorimit dhe përfshirja e tyre në raportimin mjedisor dhe social.	Për t'u zbatuar
Angazhimi i kontraktorëve	Kontraktorët duhet t'u pëmbahen procedurave të angazhimit të palëve të interesuara dhe të ankesave.	Nuk trajtohet në procedurat e VNM Paraprake.	Kontraktorët që ndërveprojnë me komunitetet lokale mund të mos ndjekin protokolle të njëtrajtshme angazhimi.	Përfshirja e kërkesave për angazhimin e palëve të interesuara dhe MA në procedurat e menaxhimit të kontraktorëve dhe CESMP.	Për t'u zbatuar

2.4. Veprimet Minimale për Arritjen e Përputhshmërisë (Projektet FV dhe BESS)

Për të arritur përputhshmërinë me Kërkesën Mjedisore dhe Sociale 10 (KMS 10), Angazhimi i Palëve të Interesuara, dhe për të plotësuar kërkesat e kufizuara për angazhimin e palëve të interesuara në kuadër të procedurës së VNM-së Paraprake në Shqipëri, Projektet angazhohen të:

- sigurojnë një proces gjithëpërfshirës të angazhimit të palëve të interesuara, të ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore;
- mbajnë kanale komunikimi transparente dhe të aksesueshme;
- monitorojnë performancën e angazhimit përmes Treguesve Kryesorë të Performancës (KPI) të matshëm;
- sigurojnë që të gjitha palët e interesuara të kenë akses në një mekanizëm ankesash funksional..

3. Përshkrimi i Projekteve dhe Zona e Ndikimit (Aol)

3.1. Përmbledhje e Përgjithshme e Projekteve

Projektet përfshijnë zhvillimin e Parqeve fotovoltaike Blue 2 dhe Blue 3, si dhe instalimeve shoqëruese të Sistemit të Ruajtjes së Energjisë me Bateri (BESS), të cilat po zhvillohen në të njëjtën zonë projekti, në zonën Seman–Sheq Marinas–Topojë të bashkisë Fier, Shqipëri.

Të gjithë komponentët ndodhen brenda së njëjtës zonë gjeografike dhe janë të ndërlidhur teknikisht përmes një infrastrukture të përbashkët elektrike, duke përfshirë nënstacionet, linjat e transmetimit dhe infrastrukturën e lidhjes me rrjetin, duke mundësuar funksionimin e projekteve si një sistem i koordinuar i energjisë së rinovueshme. Zonat e projektit janë planifikuar kryesisht në toka të degraduara ose me produktivitet të ulët, të ndikuara nga kripëzimi dhe mungesa e sistemit të ujitjes/kullimit, me vlerë të ulët bujqësore.

Projekti kontribuon në përpjekjet e vazhdueshme të Shqipërisë për diversifikimin e burimeve të prodhimit të energjisë elektrike, rritjen e kapaciteteve të energjisë së rinovueshme, përmirësimin e stabilitetit të rrjetit dhe uljen e varësisë nga prodhimi hidroenergjetik dhe importet e energjisë elektrike.

3.2. Vendndodhja dhe Kushtet Përreth

Projekti ndodhet në Njësinë Administrative Topojë, Bashkia Fier, një zonë kryesisht rurale, e karakterizuar nga vendbanime të shpërndara dhe nga një përdorim bujqësor i tokës. Sipas Censit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011, Njësia Administrative Topojë kishte rreth 4,246 banorë. Sipas Censit 2023 të INSTAT-it, popullsia ka rënë në 3,059 banorë, që përfaqëson një ulje prej rreth 28%. Kjo rënie është në përputhje me tendencat më të gjera të migrimit dhe plakjes së popullsisë në zonat rurale të Shqipërisë.

Sipas Censit 2023, nga 3,059 banorë gjithsej, 1,564 janë meshkuj (51.1%) dhe 1,495 janë femra (48.9%), duke treguar një shpërndarje relativisht të balancuar gjinore.

Popullsia në moshë pune (15–64 vjeç) përbën grupin më të madh, me 1,781 persona ose 58.2% të popullsisë së përgjithshme. Ky grup përfshin 916 meshkuj dhe 865 femra. Kjo tregon se pjesa më e madhe e popullsisë është në moshë aktive për punë.

Grup mosha 0–14 vjeç përbëhet nga 305 persona, ose 10.0% e popullsisë, prej të cilëve 175 janë meshkuj dhe 130 femra. Popullsia 65 vjeç e lart përbëhet nga 973 persona, ose 31.8% e popullsisë, prej të cilëve 473 janë meshkuj dhe 500 femra. Përqindja relativisht e lartë e personave të moshuar tregon një tendencë të dukshme të plakjes demografike.

Në tërësi, profili demografik i Topojës karakterizohet nga një shumicë e popullsisë në moshë pune, një shpërndarje relativisht e balancuar gjinore dhe një përqindje e konsiderueshme e banorëve të moshuar. Këto karakteristika mund të ndikojnë në nevojat e ardhshme për shërbime publike, veçanërisht në fushën e kujdesit shëndetësor dhe mbështetjes sociale.

Zona më e gjerë është përdorur tradicionalisht për bujqësi. Megjithatë, vëzhgimet në terren dhe konsultimet e zhvilluara tregojnë se parcelat e përzgjedhura për parqet fotovoltaike nuk kultivoheshin dhe nuk përdoreshin në mënyrë aktive përpara zhvillimit të Projektit. Tokat në zonën e Projektit karakterizohen nga prodhimtari e ulët bujqësor, mundësi të kufizuara për ujitje dhe nivele të larta kripëzimi. Këto kushte lidhen pjesërisht me praktikën historike bujqësore, përfshirë përdorimin intensiv të kimikateve bujqësore para viteve 1990, si dhe me proceset e erozionit të ndikuara nga afërsia me zonën bregdetare. Si rezultat, produktiviteti i tokës është ulur ndjeshëm dhe disa pjesë të zonës janë braktisur gradualisht nga përdorimi bujqësor.

Zona e Projektit nuk ndërhyr në infrastrukturën ekzistuese bujqësore, në rrjetet e ujitjes apo në rrugët e aksesit të përdorura nga pronarët dhe përdoruesit e tokave përreth. Aktivitetet bujqësore në zonat ngjitur pritet të vazhdojnë normalisht. Masat e planifikuara për përgatitjen e terrenit dhe përmirësimin e kullimit pritet të përmirësojnë kushtet lokale të drenazhimit dhe mund të ndihmojnë në reduktimin e grumbullimit sezonal të ujit në tokat bujqësore përreth.

Rënia e popullsisë, përdorimi i kufizuar bujqësor i tokës së prekur dhe mungesa e vendbanimeve brenda zonës së Projektit ulin mundësinë e ndikimeve të rëndësishme negative socio-ekonomike. Në të njëjtën kohë, angazhimi me palët e interesuara i zhvilluar deri më sot tregon një qëndrim përgjithësisht neutral deri pozitiv ndaj zhvillimit të energjisë së rinovueshme në zonë.

Vendbanimet më të afërta dhe distancat e tyre nga vendndodhja e zonës së projektit përfshijnë fshatrat:

- Grykë (rreth 2 km);
- Sheq Marinas (rreth 2,8 km);
- Topojë (rreth 3,6 km);
- Gjokalli (rreth 3,2 km);
- Seman (rreth 3,5 km).

Harta në vijim paraqet vendndodhjen e Projekteve në raport me zonën përreth.




Figura 1 Harta e objekteve Blue 2 dhe Blue 3, dhe e Sistemit të Ruajtjes së Energjisë me Bateri (BESS)

Peizazhi përreth karakterizohet kryesisht nga ultësira të sheshta, me lartësi që variojnë nga 0 deri në 100 metra mbi nivelin e detit. Zona më e gjerë përfshin fusha bujqësore, kanale kullimi, grykëderdhje lumore, duna bregdetare dhe mjedise lagunore. Zona specifike e përzgjedhur për Projektin përbëhet kryesisht nga toka të degraduara, me nivele të larta kripëzimi dhe produktivitet të ulët bujqësor.

3.2.1. Projekti Fotovoltaik Blue 2

3.2.1.1. Përshkrimi i Projektit

Ndërtimi i Blue 2 po zbatohet në dy faza, si pjesë e të njëjtit projekt që lidhet me të njëjtën infrastrukturë të përbashkët të rrjetit elektrik.

- Faza 1, me një kapacitet të instaluar prej rreth 64.15 MWp DC, është në operim që prej gushtit 2025.
- Faza 2, me një kapacitet shtesë prej rreth 53 MWp DC, është aktualisht në ndërtim, vënia në punë e planifikuar në mesin e vitit 2026.

Kapaciteti total i instaluar i të dy fazave është rreth 117 MWp DC, duke e klasifikuar Projektin ndër parqet fotovoltaike më të mëdha të lidhura me rrjetin elektrik.

Centrali përdor module fotovoltaike bifaciale me xham të dyfishtë, të montuara në sisteme gjurmuese me një aks, për të optimizuar prodhimin e energjisë në kushtet lokale të rrezatimit diellor. Energjia elektrike e prodhuar nga modulet fotovoltaike konvertohet nga rrymë e vazhduar (DC) në rrymë alternative (AC)

përmes inverterëve dhe transmetohet, nëpërmjet stacioneve transformuese të tensionit të mesëm, drejt nënstacionit të përbashkët të centralit. Prej këtij nënstacioni, energjia elektrike injektohet në rrjetin kombëtar përmes një lidhjeje të dedikuar të transmetimit, e vendosur rreth 3.8 km nga zona e Projektit.

Faza 2 shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 75 hektarësh. Toka është siguruar përmes një kombinimi të blerjes dhe marrjes me qira të pronave private, së bashku me një sipërfaqe më të vogël në pronësi të bashkisë, të marrë me qira përmes procedurave formale. Në total, rreth 69 ha janë siguruar për SPV-në përmes blerjes dhe marrëveshjeve të qirasë, ndërsa rreth 6 ha janë marrë me qira nga bashkia.

Titulli juridik dhe të drejtat e përdorimit mbi tokën janë verifikuar përmes të dhënave kadastrale, kontratave të noterizuara dhe vendimeve përkatëse të bashkisë. Gjithashtu, është konfirmuar se parcelat e tokës nuk janë objekt i mosmarrëveshjeve të pazgjidhura apo barrëve juridike. Transaksionet me pronarët privatë janë realizuar mbi baza vullnetare, përmes negociatave të drejtpërdrejta dhe informimit mbi Projektin, të mbështetura nga referenca për vlerësimin ose çmimin e pronës dhe nga marrëveshje të dokumentuara.

Të gjithë pronarët dhe përdoruesit përkatës të tokës janë identifikuar përmes verifikimit kadastral dhe vrojtimeve në terren. Me ta janë zhvilluar konsultime për t'i informuar mbi qëllimin dhe shtrirjen e Projektit, nevojat për tokë dhe afatet e punimeve të ndërtimit. Procesverbalet e konsultimeve, listat e pjesëmarrjes dhe korrespondenca përkatëse ruhen si pjesë e dokumentacionit të Projektit.

Verifikimet në terren dhe vlerësimi paraprak socio-ekonomik konfirmuan se nuk ka pasur zhvendosje fizike dhe se ndikimet ekonomike kanë qenë të papërfillshme. Në rastet kur janë identifikuar shqetësime të vogla dhe të përkohshme, ato janë trajtuar përmes masave zbutëse të dakordësuara dhe, sipas rastit, përmes garantimit të vazhdimësisë së aksesit.

Është krijuar dhe u është bërë i njohur palëve të interesuara një mekanizëm ankesash, i cili përcakton procedura të qarta dhe pika kontakti për paraqitjen e shqetësimeve që lidhen me sigurimin e tokës, aktivitetet e ndërtimit ose operimin e Projektit. Të dhënat mbi angazhimin e palëve të interesuara dhe çdo ankesë të paraqitur mbahen në regjistra të strukturuar.

I gjithë dokumentacioni që lidhet me blerjen dhe marrjen me qira të tokës, duke përfshirë ekstraktet kadastrale, kontratat, regjistrimet e konsultimeve dhe konfirmimet e pagesave, është sistemuar në një dosje të gjurmueshme të sigurimit të tokës dhe referohet në dokumentacionin e menaxhimit mjedisor dhe social, për të lehtësuar monitorimin, auditimin dhe shqyrtimin nga huadhënësit.

3.2.1.2. Aktivitetet e ndërtimit

Aktivitetet e ndërtimit përfshijnë instalimin e strukturave mbajtëse, moduleve, kablove të brendshme, stacioneve të inverterëve, rrugëve të aksesit dhe objekteve të përkohshme të ndërtimit, si zonat e depozitimit, punishtet dhe njësitë e mirëqenies së punonjësve. Këto objekte të përkohshme do të hiqen ose rehabilitohen pas përfundimit të ndërtimit.

Kalendari i projektit përfshin një periudhë të parashikuar ndërtimi prej rreth 18 deri në 24 muaj, e ndjekur nga aktivitete operationale të kufizuara kryesisht në mirëmbajtje, inspektim periodik dhe menaxhim vegjetacioni brenda zonës së centralit.

3.2.1.3. Fazat e Projektit

Projekti do të zbatohet në fazat e mëposhtme:

- Mobilizimi dhe përgatitja e vendndodhjes;
- Ndërtimi dhe instalimi;
- Operimi dhe mirëmbajtja;

- Faza e Çmontimit dhe Rehabilitimit të Zonës.

3.2.2. Projekti Fotovoltaik Blue 3

3.2.2.1. Vendndodhja dhe Kushtet Përreth

Centrali fotovoltaik Blue 3 ndodhet brenda së njëjtës zonë të përgjithshme projekti si Blue 2, në zonën bregdetare të Semanit, Bashkia Fier, rreth 2–3 km nga bregdeti i Adriatikut.

Zona e Projektit përbëhet kryesisht nga tokë e kënetës me kripëzim të lartë dhe një rrjet ekzistues kanalesh kullimi. Vendndodhja gjendet në një distancë të konsiderueshme nga zonat e mbrojtura dhe qendrat kryesore urbane, dhe është përzgjedhur për të minimizuar ndikimet mjedisore dhe sociale në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare.

3.2.2.2. Përshkrimi i Projektit

Projekti Blue 3 përfshin ndërtimin dhe operimin e një centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar rreth:

- 36 MW (AC).

Projekti përfshin:

- panele fotovoltaike të montuara mbi struktura fikse;
- njësi inverterësh dhe pajisje elektrike;
- kabllim dhe infrastrukturë të brendshme;
- linjë transmetimi nëntokësore që lidh me nënstacionin e Blue 2;
- rrugë aksesit dhe objekte ndihmëse.

Energjia elektrike e prodhuar në Blue 3 do të transmetohet përmes kablove nëntokësore të tensionit të mesëm drejt nënstacionit të Blue 2 dhe më pas drejt rrjetit kombëtar të transmetimit.

3.2.2.3. Fazat e Projektit

Zhvillimi i Blue 3 do të ndjekë të njëjtat faza si Blue 2:

- Përgatitja e vendndodhjes;
- Ndërtimi;
- Operimi;
- Faza e Çmontimit dhe Rehabilitimit të Zonës.

3.2.2.4. Arsyeimi Strategjik

Projekti kontribuon në:

- diversifikimin e miksit energjetik të Shqipërisë,
- përmirësimin e sigurisë energjetike,
- reduktimin e emetimeve të gazeve serrë,
- rritjen e integritetit të burimeve të energjisë së rinovueshme në rrjetin kombëtar.

3.2.3. Sistemi i Ruajtjes së Energjisë me Bateri (BESS)

3.2.3.1. Përmbledhje

Projekti përfshin zhvillimin e objekteve të Sistemit të Ruajtjes së Energjisë me Bateri (BESS), të vendosura brenda vendndodhjes së Blue 2 dhe së njëjtës zonë të gjerë projekti. Këto objekte janë projektuar për të ruajtur energjinë elektrike të prodhuar nga centralet fotovoltaike operacionale dhe për të mbështetur stabilitetin e rrjetit, menaxhimin e kulmit dhe integrimin më efikas të energjisë së rinovueshme në sistemin e transmetimit. Kapacitetet e planifikuara të ruajtjes janë si më poshtë:

- BESS Blue 1: rreth 10 MW / 26,75 MWh
- BESS Blue 2: rreth 30 MW / 80,25 MWh

Instalimet BESS do të operojnë në koordinim me centralet FV përkatëse dhe infrastrukturën elektrike të përbashkët, duke qenë pjesë e zhvillimit të integruar të energjisë së rinovueshme në zonën e projektit.

3.2.3.2. Komponentët Kryesorë

Objektet BESS do të përfshijnë:

- kontejnerë baterish;
- sisteme kondicionimi të energjisë;
- transformatorë dhe pajisje ndarëse;
- Sisteme SCADA dhe Menaxhimi të Energjisë;
- rrugë të brendshme dhe kullim;
- sisteme mbrojtjeje nga zjarri dhe sigurie;
- infrastrukturë sigurie dhe monitorimi.

3.2.3.3. Funkzioni dhe Përfitimet

Ruajtja me bateri do të:

- mbështesë stabilitetin e rrjetit;
- reduktojë kufizimin e prodhimit nga burimet e rinovueshme;
- përmirësojë besueshmërinë e furnizimit me energji elektrike;
- rrisë fleksibilitetin operacional të sistemit energjetik.

3.2.4. Fazat Aktuale

Tabela 2 Kalendar i Zbatimit të PAPI-it – Projektet Blue dhe BESS

Projekti	Statusi Aktual	Faza e Projektit	Aktivitetet Kryesore të PAPI (KMS 10)	Rezultatet e Pritshme
Blue 1	Në operim	Faza e operimit	Komunikim i vazhdueshëm me komunitetet dhe autoritetet lokale. Mbajtja e mekanizmit të ankesave për fazën e operimit.	Regjistri i ankesave Regjistrimet e komunikimit me palët e interesuara

Projekti	Statusi Aktual	Faza e Projektit	Aktivitetet Kryesore të PAPI (KMS 10)	Rezultatet e Pritshme
			Publikimi i informacionit të rëndësishëm mbi performancën mjedisore dhe sociale, kur kërkohet.	Raportim periodik mjedisor dhe social
Blue 2 – Faza 1 (64,15 MWp)	Në operim	Faza e operimit	Angazhim i vazhdueshëm me komunitetet dhe përdoruesit e afërt të tokës. Komunikim mbi aktivitetet e mirëmbajtjes ose çështjet operationale, kur është e rëndësishme. Mekanizmi i ankesave i mbajtur aktiv.	Regjistrimet e zbatimit të PAPI Shënimet e takimeve me palët e interesuara
Blue 2 – Faza 2 (52,10 MWp)	Në ndërtim	Faza e ndërtimit	Angazhim i rregullt me banorët lokalë dhe autoritetet bashkiake. Publikimi i kalendarit të ndërtimit, trafikut dhe shqetësimeve të mundshme. Mekanizma aktivë ankesash për komunitetin dhe punonjësit. Monitorimi dhe dokumentimi i shqetësimeve të palëve të interesuara.	Regjistrimet e konsultimit Regjistri i ankesave Shënime periodike monitorimi të PAPI
Blue 3	Leja e ndërtimit në proces aplikimi	Marrja e lejeve / Para-ndërtimi	Publikimi i informacionit dhe projektimit të projektit. Konsultim me palët e interesuara dhe autoritetet e prekura. Dokumentimi i vërejtjeve dhe integrimi i tyre në dokumentacionin e projektit. Përditësimi i PAPI përpara fillimit të ndërtimit.	Regjistrimet e konsultimit PAPI i përditësuar Baza e të dhënave të palëve të interesuara
Të gjitha Projektet Blue	I vazhdueshëm	Të gjitha fazat	Shqyrtim dhe përditësim periodik i PAPI. Mbajtja e bazës së të dhënave të palëve të interesuara dhe mekanizmit të ankesave. Raportim tek huadhënësit dhe autoritetet, sipas nevojës.	PAPI i përditësuar Raporte vjetore ose periodike të angazhimit të palëve të interesuara

3.2.5. Fuqia Punëtore dhe Aktivitetet

Gjatë fazës së ndërtimit, Projekti do të punësojë një fuqi punëtore të përkohshme, duke përfshirë punonjës të kualifikuar dhe të pakualifikuar, kontraktorë dhe nënkontraktorë. Gjatë operimit, fuqia punëtore do të jetë dukshëm më e vogël dhe e fokusuar në aktivitete operimi, mirëmbajtjeje dhe monitorimi.

Nuk pritët të kërkohet akomodim i punonjësve në shkallë të gjerë dhe, aty ku është e mundur, shumica e punonjësve pritët të rekrutohen në nivel lokal ose rajonal.

3.3. Zona e Ndikimit të Projektit

3.3.1. Përkufizimi i Zonës së Ndikimit

Objektet Blue 2, Blue 3 dhe BESS po zhvillohen brenda së njëjtës zonë të përgjithshme gjeografike dhe janë të integruara teknikisht përmes infrastrukturës elektrike të përbashkët dhe operimit të koordinuar.

Projektet ndodhen në një zonë tashmë të karakterizuar nga infrastruktura energjetike dhe përdorimi bujqësor i tokës, dhe janë vendosur për të shmangur:

- Vendbanimet;
- zonat e mbrojtura;
- tokën bujqësore me vlerë të lartë, aty ku është e mundshme.

Të gjitha projektet ndodhen në zonën e grykëderdhjes së lumit Seman, e karakterizuar nga:

- Terren i sheshtë dhe i ulët;
- Tokë bujqësore dhe kanale kullimi;
- Afërsi me pyjet bregdetare të pishave dhe bregdetin e Adriatikut;
- Infrastrukturë ekzistuese e energjisë së rinovueshme dhe elektrike në zonën më të gjerë.

Aktivitetet e angazhimit do të zbatohen gjatë ndërtimit dhe operimit në përputhje me kërkesat e BERZH-it (KMS-të) dhe legjislacionin shqiptar. Për qëllime të angazhimit të palëve të interesuara, Zona e Ndikimit të Projektit (Aol) është përcaktuar në përputhje me KMS 1 të BERZH-it: Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rreziqeve dhe Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale, dhe KMS 10: Angazhimi i Palëve të Interesuara. Aol përfshin zonat potencialisht të prekura nga ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta mjedisore dhe sociale, si dhe zonat ku palët e interesuara mund të kenë interes për Projektin.

Zona e Ndikimit ndahet në tre zona:

- Zona Kryesore e Ndikimit.
- Zona Dytësore e Ndikimit.
- Zona më e Gjerë e Interesit.

3.3.2. Zona Kryesore e Ndikimit

Zona Kryesore e Ndikimit përfshin zonat ku mund të ndodhin ndikime të drejtpërdrejta, duke përfshirë:

- Gjurmën e centraleve fotovoltaike Blue 2 dhe Blue 3.
- Objektet BESS.
- Nënstacionet dhe infrastrukturën e lidhjes me rrjetin.
- Rrugët e brendshme të aksesit dhe zonat e ndërtimit.
- Zonat e depozitimit dhe grumbullimit të përkohshëm.
- Rrugët e transmetimit nëntokësore ose ajrore.

Ndikimet e mundshme në këtë zonë mund të përfshijnë:

- Zhurmë dhe pluhur të lidhur me ndërtimin.

- Lëvizje të përkohshme trafiku dhe transporti.
- Rreziqe të shëndetit dhe sigurisë në punë.
- Shqetësim të përkohshëm të tokës.

3.3.3. Zona Dytësore e Ndikimit

Zona Dytësore e Ndikimit përfshin zonat që mund të përjetojnë ndikime të tërthorta, duke përfshirë:

- Vendbanimet e vendosura brenda zonës më të gjerë të projektit përfshijnë fshatrat Grykë, Sheq Marinas, Topojë, Gjakalli dhe Seman (siç tregohet në Harta e objekteve Blue 2 dhe Blue 3, dhe e Sistemit të Ruajtjes së Energjisë me Bateri (BESS)).
- Rrugët lokale të përdorura për transportin e materialeve dhe pajisjeve.
- Tokën bujqësore dhe sistemet e kullimit në afërsi.
- Zonat ku shërbimet lokale mund të përjetojnë kërkesë të shtuar gjatë ndërtimit.

Ndikimet e mundshme të tërthorta mund të përfshijnë:

- Rritje të trafikut në rrugët lokale.
- Shqetësim të përkohshëm gjatë ndërtimit.
- Efekte ekonomike lokale, duke përfshirë mundësitë e punësimit.

3.3.4. Zona më e Gjerë e Interesit

Zona më e Gjerë e Interesit përfshin palët e interesuara që mund të mos preken drejtpërdrejt, por që mund të kenë interes për Projektin, duke përfshirë:

- Bashkinë Fier dhe autoritetet rajonale.
- Institucionet rregullatore dhe mjedisore kombëtare.
- Operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Organizatat jofitimprurëse.
- Institucionet akademike.
- Publikun e gjerë.

Zona Dytësore e Ndikimit dhe Zona më e Gjerë e Ndikimit mund të preken nga ndikimi kumulativ i projekteve të tjera të zhvilluara ose në zhvillim në zonë:

- Projekti TAP;
- Centrali Fotovoltaik i Topojës, ndërtuar nga "AED Solar" sh.p.k., me kapacitet të instaluar 2 MW;
- Një projekt i ri, "Natyral Energy System" sh.p.k., miratuar nga MIE për ndërtimin e një centrali eolik me kapacitet 3 MW, në fshatin Grykë, NJA Topojë, Bashkia Fier; dhe
- Parku Fotovoltaik Karavasta, me kapacitet të instaluar 140 MW, ndodhet në fazën e operimit dhe aktivitetet kryesore në terren lidhen me mirëmbajtjen.
- Karavasta 140 MW - Parku Fotovoltaik dhe LTH Parku Fotovoltaik Karavasta ndodhet në Remas - Karavasta Divjakë, Lushnje dhe Libofshë Fier. Projekti është operacional dhe ndodhet 1,8 km larg

SPV-së Blue 3. Ai mbulon një sipërfaqe prej 196 ha. Linja përkatëse e transmetimit ajror (LTH) 220 kV do të kalojë

- Linja e transmetimit shtrihet rreth 19,2 km në drejtim juglindor nga SPV-ja Karavasta drejt nënstationit të Fierit, duke siguruar lidhjen e centralit FV me rrjetin kombëtar. Ajo ndodhet 2,9 km larg SPV-së Blue 3. SPV Karavasta aktualisht ndodhet në fazën e operimit, me aktivitete në terren të lidhura kryesisht me mirëmbajtjen rutinë.

Harta në vijim paraqet vendndodhjen e projekteve në raport me zonën e Projektit të mbuluar nga ky PAPI, duke treguar që ato ndodhen brenda së njëjtës zonë ndikimi.




Figura 2 Projektet Blue dhe Projekte të tjera në zonë

3.3.5. Receptorët e Ndjeshëm

Receptorët e ndjeshëm brenda ose pranë Zonës së Ndikimit përfshijnë:

- Zonat rezidenciale në fshatrat në afërsi.
- Tokën bujqësore dhe infrastrukturën e ujitjes.
- Përdoruesit e rrugëve lokale.
- Kanalet e ujërave sipërfaqësorë dhe sistemet e kullimit.

Këta receptorë merren në konsideratë gjatë planifikimit të aktiviteteve të angazhimit dhe komunikimit me palët e interesuara.

3.3.6. Zona e Ndikimit për Angazhimin e Palëve të Interesuara

Për qëllime të angazhimit të palëve të interesuara, do t'i jepet përparësi:

- Komuniteteve më të afërta me vendndodhjet e projektit.
- Përdoruesve të tokës dhe fermerëve në zonat ngjitur.
- Autoriteteve lokale dhe njësive administrative.
- Institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e infrastrukturës dhe mjedisit.

Aktivitetet e angazhimit do të shkallëzohen sipas nivelit të ndikimit të mundshëm dhe interesit të palëve të interesuara.

4. Identifikimi dhe Analiza e Palëve të Interesuara

4.1. Qëllimi i Identifikimit të Palëve të Interesuara

Identifikimi i palëve të interesuara kryhet për të siguruar që të gjithë individët, grupet dhe organizatat që mund të preken nga Projekti, ose që mund të kenë interes në zbatimin e tij, të informohen dhe të konsultohen në mënyrën e duhur.

Në përputhje me Kërkesën Mjedisore dhe Sociale 10 (KMS 10) të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), palët e interesuara identifikohen dhe analizohen me qëllim që:

- të kuptohet natyra dhe shkalla e ndikimeve të mundshme mbi grupe të ndryshme;
- të identifikohen palët e interesuara për të cilat mund të nevojiten forma të posaçme ose të synuara angazhimi;
- të sigurohet që grupet vulnerabël ose në disavantazh të mos përjashtohen nga procesi i konsultimit;
- të përcaktohen metodat e përshtatshme dhe shpeshtësia e angazhimit; dhe
- të mbështetet komunikimi efektiv dhe menaxhimi i ankesave.

Identifikimi i palëve të interesuara është një proces i vazhdueshëm dhe do të rishikohet periodikisht në përputhje me ecurinë e Projektit.

4.2. Metodologjia për Identifikimin e Palëve të Interesuara

Palët e interesuara janë identifikuar bazuar në kriteret e mëposhtme:

- afërsia me zonat dhe infrastrukturën e Projektit;
- ekspozimi i mundshëm ndaj ndikimeve mjedisore ose sociale;
- përgjegjësitë administrative ose rregullatore;
- pronësia ose përdorimi i tokës dhe infrastrukturës;
- interesi ekonomik ose social në lidhje me Projektin;
- përvoja e fituar nga projekte të ngjashme në Shqipëri; dhe
- konsultimet e zhvilluara gjatë fazës së përgatitjes së Projektit.

Analiza merr gjithashtu në konsideratë nivelin e ndikimit dhe nivelin e interesit të secilit grup të palëve të interesuara, me qëllim përcaktimin e përparësive për aktivitetet e angazhimit.

4.3. Kategoritë e Palëve të Interesuara

Për qëllimet e këtij PAPI, palët e interesuara grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- Palët e interesuara të prekura nga Projekti (drejtpërdrejt ose tërthorazi):
 - komunitetet lokale pranë zonës së Projektit dhe brenda Zonës së Ndikimit (Aol);
 - pronarët e tokës, qiramarrësit dhe përdoruesit jo-formalë të tokës;
 - punonjësit, përfshirë punonjësit e kontraktorëve dhe ata të zinxhirit të furnizimit;
 - grupet vulnerabël ose në disavantazh, për shembull familjet me të ardhura të ulëta, grupet minoritare dhe të moshuarit.
- Palët e tjera të interesuara:
 - autoritetet shtetërore në nivel qendror dhe lokal;
 - institucionet dhe autoritetet rregullatore;
 - organizatat joqeveritare dhe organizatat e shoqërisë civile;
 - bizneset dhe shoqatat ose grupet e industrisë;
 - mediat dhe institucionet akademike.

Secila prej këtyre kategorive përshkruhet më poshtë.

4.3.1. Palë Interesi të Prekura nga Projekti

4.3.1.1. Komunitetet lokale pranë vendndodhjes së projektit

Komunitetet e prekura nga Projekti përkufizohen si individët dhe familjet që ndodhen brenda Zonës së Ndikimit (Aol) dhe që mund të përjetojnë ndikime të drejtpërdrejta ose të tërthorta gjatë fazës së ndërtimit ose operimit.

Këto komunitete përfshijnë banorët e vendbanimeve që ndodhen në afërsi të zonës së Projektit, përfshirë fshatrat Grykë, Sheq Marinas, Topojë, Gjokalli dhe Seman, në territorin e Bashkisë Fier.

Interesat dhe shqetësimet kryesore të komuniteteve të prekura nga Projekti mund të përfshijnë:

- trafikun e lidhur me aktivitetet e ndërtimit dhe sigurinë rrugore;
- zhurmën dhe pluhurin e përkohshëm gjatë fazës së ndërtimit;
- mundësitë e punësimit;
- aksesin në tokë dhe aktivitetet bujqësore;
- shëndetin dhe sigurinë e komunitetit; dhe
- praninë afatgjatë të infrastrukturës së Projektit në peizazh.

Këto palë të interesuara konsiderohen si një grup me përparësi të lartë për procesin e angazhimit dhe konsultimit.

4.3.1.2. Pronarët e tokës, qiramarrësit dhe përdoruesit jo-formalë të tokës

Trualli i nevojshëm për Projektin është siguruar përpara fazës aktuale të zhvillimit. Megjithatë, në përputhje me kërkesat e BERZH-it, individët dhe grupet që janë prekur ose mund të jenë prekur nga proceset e mëparshme të marrjes së tokës konsiderohen palë të interesuara të prekura nga Projekti.

Përpara sigurimit të tokës për Projektin, trualli nuk ka pasur përdorim të konsiderueshëm produktiv, për shkak të pjellorisë së ulët të tokës dhe potencialit të kufizuar për shfrytëzim bujqësor. Për rrjedhojë, toka nuk kultivohej në mënyrë aktive dhe nuk përdorej për veprimtari që gjeneronin të ardhura.

Toka ishte në pronësi të individëve privatë, të cilët tashmë konsiderohen ish-pronarë të tokës. Në kohën e marrjes së saj për Projektin, këta individë nuk banonin në truall dhe nuk e përdornin atë. Gjithashtu, në momentin e marrjes së tokës nuk janë identifikuar qiramarrës apo përdorues jo-formalë.

Bazuar në informacionin e disponueshëm, nuk është identifikuar asnjë zhvendosje fizike dhe as ndonjë zhvendosje ekonomike e lidhur me humbjen ose cenimin e mjeteve të jetesës. Megjithatë, në përputhje me kërkesat e BERZH-it, ish-pronarët e tokës njihen si palë të interesuara të prekura nga Projekti për shkak të procesit të mëparshëm të marrjes së tokës. Projekti do të sigurojë që këto palë të kenë akses në mekanizmin për trajtimin e ankesave, në rast se lindin shqetësime të mbetura ose çështje të pazgjidhura që lidhen me procesin e marrjes së tokës.

4.3.1.3. Bizneset, Përdoruesit e Tokës dhe Operatorët e Infrastrukturës pranë Vendndodhjes së Projektit dhe Rrugëve të Transportit

Kjo kategori përfshin:

- fermerët vendas dhe përdoruesit e tokës në afërsi të truallit të Projektit;
- bizneset e vogla në vendbanimet pranë zonës së Projektit dhe përgjatë rrugëve të transportit;
- kontraktorët dhe ofruesit e shërbimeve;
- operatorët e infrastrukturës ekzistuese, si tubacionet, kanalet kulluese, linjat e transmetimit të energjisë elektrike dhe rrugët.

Këto kategori të palëve të interesuara mund të përjetojnë ndikime të tërthorta, duke përfshirë shqetësime të përkohshme gjatë fazës së ndërtimit ose ndryshime në kushtet e aksesit. Në të njëjtën kohë, ato mund të përfitojnë edhe nga mundësitë ekonomike që lidhen me zbatimin e Projektit..

4.3.1.4. Punonjësit dhe Kontraktorët

Punonjësit e angazhuar në Projekt përbëjnë një grup të veçantë të palëve të interesuara sipas Kërkesës Mjedisore dhe Sociale 2 të BERZH-it (KMS 2 – Puna dhe Kushtet e Punës).

Ky grup përfshin:

- punonjësit e drejtpërdrejtë të Zhvilluesit të Projektit;
- punonjësit e kontraktorëve dhe nënkontraktorëve;
- punonjësit e përkohshëm të angazhuar gjatë fazës së ndërtimit;
- personelin e operimit dhe mirëmbajtjes.

Çështjet kryesore me rëndësi për këtë grup përfshijnë:

- shëndetin dhe sigurinë në punë;
- kushtet e punës;

- akomodimin dhe mirëqenien e punonjësve;
- aksesin në një mekanizëm të posaçëm për trajtimin e ankesave të punonjësve.

Në përputhje me KMS 2, do të zbatohet një mekanizëm i veçantë për trajtimin e ankesave të punonjësve.

4.3.1.5. Grupet e Cenueshme ose në Disavantazh

Në përputhje me Kërkesën Mjedisore dhe Sociale 10 të BERZH-it (KMS 10), vëmendje e veçantë i kushtohet identifikimit të grupeve vulnerabël ose në disavantazh, të cilat mund:

- të preken në mënyrë joproporcionale nga ndikimet e Projektit;
- të kenë akses të kufizuar në informacion;
- të përballen me pengesa për pjesëmarrjen në proceset e konsultimit.

Grupet potencialisht vulnerabël në zonën e Projektit mund të përfshijnë:

- banorët e moshuar në komunitetet rurale;
- familjet me të ardhura të ulëta;
- fermerët e vegjël që varen nga infrastruktura lokale;
- personat me aftësi të kufizuara;
- gratë në familje me mundësi të kufizuara për pjesëmarrje në proceset publike të vendimmarrjes.

Identifikimi i grupeve vulnerabël në Njësinë Administrative Topojë bazohet në të dhënat e Censit 2023 të INSTAT-it dhe merr në konsideratë kërkesat e BERZH-it për paraqitjen e të dhënave sipas kategorive dhe gjinisë. Analiza përfshin si numrin absolut të personave, ashtu edhe përqindjen e tyre në popullsinë përkatëse, me qëllim mbështetjen e angazhimit të palëve të interesuara dhe planifikimit gjithëpërfshirës mbi bazën e të dhënave.

- Popullsia e moshuar (65 vjeç e lart): Në Njësinë Administrative Topojë, popullsia e moshës 65 vjeç e lart përbëhet nga 973 persona, që përfaqësojnë 31,8% të popullsisë së përgjithshme. Prej tyre, 473 janë meshkuj, ose 30,2% e popullsisë mashkullore, ndërsa 500 janë femra, ose 33,4% e popullsisë femërore. Këto të dhëna tregojnë një nivel të konsiderueshëm të plakjes së popullsisë, me një përqindje disi më të lartë te gratë. Ky ndryshim gjinor lidhet me jetëgjatësinë më të lartë të grave dhe evidenton nevojën për masa të përshtatura në fushën e kujdesit shëndetësor, mbrojtjes sociale dhe shërbimeve mbështetëse, veçanërisht për gratë e moshuara, të cilat mund të jenë më të ekspozuara ndaj izolimit social dhe cenueshmërisë ekonomike.
- Personat me aftësi të kufizuara ose vështirësi në kryerjen e aktiviteteve të përditshme: Në total, 454 persona, ose 16,5% e popullsisë së vlerësuar prej 2 754 personash, raportohen se kanë vështirësi. Kjo kategori përfshin 202 meshkuj, që përfaqësojnë 14,5% të popullsisë mashkullore, dhe 252 femra, që përfaqësojnë 18,5% të popullsisë femërore. Të dhënat tregojnë një përqindje më të lartë te gratë, duke evidentuar një dimension gjinor të cenueshmërisë brenda këtij grupi. Personat me aftësi të kufizuara përbëjnë një grup të rëndësishëm për masat gjithëpërfshirëse, veçanërisht në lidhje me aksesueshmërinë, kujdesin shëndetësor, punësimin dhe pjesëmarrjen në jetën publike, në përputhje me kërkesat e BERZH-it për përfshirjen sociale.
- Popullsia analfabete: Numri i personave analfabetë është 116, ose 4,0% e popullsisë së moshës 6 vjeç e lart, e cila përbëhet nga 2 878 persona. Megjithatë nuk disponohen të dhëna të ndara sipas gjinisë, ky grup konsiderohet vulnerabël për shkak të aksesit më të kufizuar në informacion, shërbime publike dhe mundësi punësimi. Analfabetizmi mund të kufizojë gjithashtu pjesëmarrjen

efektive në proceset e angazhimit dhe konsultimit me palët e interesuara, duke e bërë të nevojshme përdorimin e formave të përshtatura të komunikimit.

- Personat pa arsim ose me nivel të kufizuar arsimor: Në total, 47 persona (1,6%) nuk kanë përfunduar asnjë nivel arsimor, ndërsa 186 persona (6,5%) nuk kanë ndjekur asnjëherë shkollën. Së bashku, këto dy kategori përbëjnë 233 persona, ose 8,1% të popullsisë së moshës 6 vjeç e lart. Këto grupe mund të përballen me pengesa strukturore në pjesëmarrjen në tregun e punës dhe në përfshirjen sociale. Megjithëse të dhënat sipas gjinisë nuk janë të specifikuara, këto forma cenueshmërie mund të jenë më të theksuara te gratë dhe grupmoshat më të mëdha, duke kërkuar masa të përshtatura për informim, ngritje kapacitetesh dhe përfshirje.
- Personat e ve: Në Njësinë Administrative Topojë janë regjistruar 278 persona të ve, që përfaqësojnë 9,1% të popullsisë së përgjithshme. Megjithëse nuk disponohen të dhëna të ndara sipas gjinisë, për shkak të karakteristikave demografike kjo kategori përbëhet zakonisht në një masë më të madhe nga gratë. Personat e ve mund të përballen me ulje të të ardhurave familjare, izolim social dhe rritje të varësisë ekonomike ose sociale, çka mund t'i bëjë ata një grup me nevoja të veçanta për mbështetje.
- Personat e vetëm (që nuk janë martuar asnjëherë): Në total, 759 persona nuk janë martuar asnjëherë, duke përfaqësuar 24,8% të popullsisë së përgjithshme. Ky grup përfshin në një masë të madhe grupmoshat e reja, por mund të përfshijë edhe persona ekonomikisht joaktivë. Megjithëse statusi i të qenit beqar nuk përbën në vetvete një tregues vulnerabiliteti, nëngrupe të caktuara, veçanërisht të rinjtë dhe gratë, mund të përballen me sfida që lidhen me punësimin, pavarësinë ekonomike dhe përfshirjen sociale.
- Personat e divorcuar ose të ndarë: Personat e divorcuar ose të ndarë janë gjithsej 44, duke përfaqësuar 1,4% të popullsisë së përgjithshme. Megjithëse ky grup është relativisht i vogël në numër, individët brenda tij mund të përballen me cenueshmëri sociale dhe ekonomike, veçanërisht në rastin e familjeve me një prind ose të personave me burime të kufizuara të ardhurash, dhe mund të kenë nevojë për forma të përshtatura mbështetjeje.

Profili i vulnerabilitetit në Njësinë Administrative Topojë evidenton disa sfida strukturore kryesore. Përqindja e lartë e personave të moshuar (31,8%) dhe e personave me aftësi të kufizuara ose vështirësi (16,5%) përbën burimin më të rëndësishëm të vulnerabilitetit. Gratë përfaqësohen në përqindje më të lartë si në grupin e të moshuarve, ashtu edhe në grupin e personave me vështirësi, çka tregon nevojën për qasje që marrin në konsideratë në mënyrë të posaçme aspektet gjinore. Vulnerabilitetet që lidhen me arsimin mbeten gjithashtu të pranishme, me 8,1% të popullsisë që rezultojnë pa arsim ose me arsimim shumë të kufizuar, pavarësisht nivelit përgjithësisht të lartë të shkrim-leximit.

Metodat e angazhimit dhe konsultimit do të përshtaten, sipas nevojës, për të siguruar që këto grupe të kenë akses të barabartë në informacion dhe mundësi efektive për të marrë pjesë në proceset e konsultimit.

4.3.2. Palë të tjera të interesuara

4.3.2.1. Autoritetet Lokale dhe Institucionet Publike

Autoritetet lokale dhe institucionet publike luajnë një rol të rëndësishëm në planifikim, koordinimin e infrastrukturës, komunikimin publik dhe monitorimin mjedisor.

Palët kryesore të interesuara në këtë kategori përfshijnë:

- Bashkinë Fier.
- Njësinë Administrative Topojë.

- autoritetet rajonale mjedisore dhe inspektuese.
- shërbimet e emergjencës dhe mbrojtjes civile.
- shërbimet publike lokale dhe operatorët e infrastrukturës.

Këto palë e interesuar zakonisht kanë ndikim të lartë dhe interes të lartë për Projektin dhe kërkojnë komunikim dhe koordinim të rregullt.

4.3.2.2. Autoritetet Kombëtare Rregullatore

Palët e interesuara në nivel kombëtar përfshijnë institucionet përgjegjëse për:

- Lejet dhe përputhshmërinë mjedisore.
- Rregullimin dhe licencimin e energjisë.
- Operimin e sistemit të transmetimit.
- Administrimin dhe planifikimin e tokës.
- Mbikëqyrjen e shëndetit dhe sigurisë në punë.

Këto palë e interesuar kanë ndikim të lartë mbi miratimet dhe përputhshmërinë e Projektit, dhe angazhimi do të fokusohet në koordinimin rregullator dhe raportim.

4.3.2.3. Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Palë të Tjera të Interesuara

Palë të tjera interesi që mund të kenë interes për Projektin përfshijnë:

- Organizatat jofitimprurëse mjedisore.
- Shoqatat e komunitetit.
- Institucionet akademike dhe kërkimore.
- Organizatat mediatike.
- Anëtarë të publikut me interes për energjinë e rinovueshme ose mbrojtjen e mjedisit.

Këto palë e interesuar mund të mos preken drejtpërdrejt, por mund të kërkojnë informacion ose të marrin pjesë në konsultime.

Tabela 3 Hartëzimi i Palëve të Interesuara

Grupi i Palëve të Interesuara	Interesat dhe Shqetësimet Kryesore	Ndikimi	Niveli i Interesit	Metodat e Propozuara të Angazhimit
Banorët dhe fermerët e fshatrave Grykë, Sheq Marinas, Topojë, Gjakall dhe Seman.	Ndikimet e ndërtimit, trafiku, zhurma, pluhuri, mundësitë e punësimit, shëndeti dhe siguria e komunitetit	I ulët– Mesatar	I lartë	Takime publike, fletëpalosje informative, mekanizëm ankesash, përditësime periodike
Bashkia Fier	Zhvillimi lokal, koordinimi i infrastrukturës, ndikimet mjedisore dhe sociale, mundësitë e punësimit	I lartë	I lartë	Takime të rregullta koordinimi, raportim formal, seminare konsultimi
Njësia Administrative Topojë mbulon zonën e Projektit	Komunikimi me komunitetet lokale, infrastruktura dhe shërbimet lokale	Mesatar	I lartë	Takime koordinimi, shkëmbim informacioni

Grupi i Palëve të Interesuara	Interesat dhe Shqetësimet Kryesore	Ndikimi	Niveli i Interesit	Metodat e Propozuara të Angazhimit
Kryetarët e fshatrave Grykë, Sheq Marinas, Topojë, Gjokalli dhe Seman.				
Autoritetet rajonale mjedisore dhe inspektuese	Përputhshmëria me legjislacionin mjedisor, monitorimi dhe raportimi	I lartë	I lartë	Raportim formal, takime teknike, vizita në terren
Autoritetet rregullatore kombëtare (mjedisi, energjia, puna, transporti) Drejtoria e Policisë Rrugore e Policisë së Shtetit, Fier, për koordinimin e menaxhimit të trafikut dhe masave të sigurisë rrugore	Përputhshmëria rregullatore, lejet, performanca mjedisore dhe sociale. Projekti do të konsultohet dhe, kur kërkohet, do të marrë miratime ose njoftime nga institucionet kompetente përgjegjëse për administrimin rrugor dhe menaxhimin e trafikut.	I lartë	Mesatar-I lartë	Paraqitje formale, takime, njoftime, raportim periodik
IKTK, autoritetet rajonale dhe lokale të trashëgimisë kulturore, dhe drejtoria e Parkut Arkeologjik të Apolonisë	Autoritetet lokale dhe institucionet e trashëgimisë kulturore, kur zbatohet, do të informohen për aktivitetet e Projektit, dhe do të zbatohet një procedurë për gjetje të rastësishme.	I lartë	Mesatar-I lartë	Takim formal
Operatori i sistemit të transmetimit dhe shërbimet publike	Lidhja me rrjetin, siguria operacionale, mbrojtja e infrastrukturës	I lartë	I lartë	Takime koordinimi teknik, komunikim formal
Kontraktorët dhe nënkontraktorët	Zbatimi i kontratës, kushtet e punës, shëndeti dhe siguria	Mesatar	I lartë	Takime me kontraktorët, orientime hyrëse, procedura angazhimi për punonjësit
Punonjësit e Projektit	Shëndeti dhe siguria në punë, kushtet e punës, strehimi, procedurat e ankesave	I ulët	I lartë	Orientim hyrës i punonjësve, biseda "toolbox", mekanizëm ankesash për punonjësit
Bizneset dhe ofruesit e shërbimeve lokale	Ndikimet e ndërtimit, trafiku, zhurma, pluhuri, mundësitë e punësimit, shëndeti dhe siguria e komunitetit. Mundësitë ekonomike, prokurimi, shërbimet lokale	I ulët	Mesatar	Publikim informacioni, takime të synuara kur është e rëndësishme
OJF-të mjedisore dhe organizatat e shoqërisë civile	Ndikimet mjedisore, biodiversiteti, praktikat e qëndrueshmërisë	Mesatar	Mesatar	Publikimi i dokumenteve VNMS, takime konsultimi, përgjigje ndaj pyetjeve
Mediat dhe publiku i gjerë	Informacioni i projektit, transparenca, interesi publik	I ulët	Mesatar	Publikim publike, faqe interneti ose materiale komunikimi

Në përputhje me KMS 10 të BERZH-it, grupet vulnerabël brenda zonës së Projektit janë identifikuar gjatë procesit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS/ESIA) dhe janë marrë në konsideratë në këtë

Plan të Angazhimit të Palëve të Interesuara. Këto grupe përfshijnë të moshuarit, familjet me të ardhura të ulëta, fermerët e vegjël, personat me aftësi të kufizuara dhe gratë në familjet rurale.

Shqetësimet e mundshme mund të lidhen kryesisht me aksesin në informacion dhe në proceset e konsultimit, mundësinë për të marrë pjesë në takime dhe, në rastin e fermerëve, me aksesin në tokë, kanalet kulluese dhe rrugët lokale. Për adresimin e këtyre çështjeve, Oficeri për Marrëdhëniet me Komunitetin (CLO) i Projektit Blue ka zhvilluar takime me përfaqësues të Njesisë Administrative Topojë dhe me kryetarët përkatës të fshatrave, si dhe ka komunikuar drejtpërdrejt me banorët vendas, sipas rasti.

Gjithashtu, janë zbatuar masa të posaçme angazhimi, duke përfshirë organizimin e takimeve lokale në forma lehtësisht të aksesueshme, përdorimin e materialeve informuese të qarta dhe të thjeshtuara, organizimin e konsultimeve në mënyrë gjithëpërfshirëse, komunikimin e drejtpërdrejtë me palët e prekura, si dhe krijimin e një mekanizmi të aksesueshëm për trajtimin e ankesave, me qëllim që shqetësimet të mund të paraqiten dhe të adresohen në kohën e duhur.

Këto masa synojnë të sigurojnë që palët vulnerabël të interesuara të mund të marrin pjesë në mënyrë efektive në procesin e angazhimit dhe të kenë akses të barabartë në informacionin mbi Projektin dhe në kanalet për paraqitjen e komenteve, shqetësimeve dhe ankesave gjatë gjithë ciklit jetësor të Projektit.

Tabela 4 Hartëzimi i Grupeve të Cenueshme

Grupi i Cenueshëm	Shqetësimet e Mundshme	Metoda e Angazhimit
Banorët e moshuar në komunitetet rurale	Akses i kufizuar në takime ose informacion	Takime lokale, materiale të thjeshtuara komunikimi
Familjet me të ardhura të ulëta	Akses i kufizuar në punësim ose informacion	Takime komuniteti, mekanizëm ankesash i arritshëm
Fermerët e vegjël	Aksesi në tokë, kullim dhe rrugë	Konsultime të synuara dhe komunikim i drejtpërdrejtë
Personat me aftësi të kufizuara	Akses në vendet e konsultimit dhe informacion	Kanale komunikimi të arritshme
Gratë në familje rurale	Pjesëmarrja në konsultime	Rregullime gjithëpërfshirëse konsultimi dhe orare fleksibël takimesh

4.4. Analiza dhe Prioritizimi i Palëve të Interesuara

Palët e interesuara janë analizuar bazuar në dy kritere kryesore:

- niveli i ndikimit ose interesit të mundshëm për Projektin;
- niveli i ndikimit mbi vendimet ose zbatimin e Projektit.

Kjo analizë mbështet zhvillimin e strategjive të synuara të angazhimit.

Interes i Lartë

OJF-të dhe organizatat lokale	Bashkia Fier
Bizneset lokale që operojnë pranë zonës së Projektit	Autoritetet rregullatore përkatëse
	Operatorët e sistemit të transmetimit
	Komunitetet lokale
	Fermerët dhe përdoruesit e tokës




Figura 3 Prioritizimi i palëve të interesuara

4.4.1. Përmbledhje e Prioritizimit të Palëve të Interesuara

Palët e interesuara janë prioritetuar bazuar në nivelin e ndikimit të mundshëm dhe ndikimin e tyre mbi zbatimin e Projektit:

Palët e interesuara me përparësi të lartë

- Komunitetet lokale në afërsi të drejtpërdrejtë të Projektit. Vendbanimet e vendosura brenda zonës më të gjerë të projektit përfshijnë fshatrat Grykë, Sheq Marinas, Topojë, Gjokalli dhe Seman
- Bashkia Fier dhe Njësia Administrative Topojë.
- Autoritetet mjedisore dhe rregullatore.
- Operatori i sistemit të transmetimit.

Palët e interesuara me përparësi mesatare

- Fermerët dhe përdoruesit e tokës.
- Bizneset lokale.
- OJF-të dhe organizatat e shoqërisë civile.

Palët e interesuara me përparësi më të ulët

- Publiku i gjerë jashtë zonës së drejtpërdrejtë të ndikimit.
- Frekuenca dhe metodat e angazhimit do të përshtaten në përputhje me rrethanat.

4.4.2. Identifikimi i Vazhdueshëm i Palëve të Interesuara

Identifikimi i palëve të interesuara është një proces dinamik dhe i vazhdueshëm. Palë të tjera të interesuara mund të identifikohen gjatë:

- fazës së projektimit të detajuar;
- aktiviteteve të ndërtimit;
- proceseve të konsultimit dhe vënies në dispozicion të informacionit;
- zbatimit të mekanizmit për trajtimin e ankesave.

Baza e të dhënave të palëve të interesuara do të përditësohet sipas nevojës gjatë gjithë ciklit jetësor të Projektit.

4.5. Përditësimi i Regjistrimit të Palëve të Interesuara

Lista dhe analiza e palëve të interesuara do të shqyrtohen dhe përditësohen:

- Përpara fillimit të ndërtimit.
- Periodikisht gjatë ndërtimit.
- Në momente kyçe gjatë operimit.
- Sa herë që identifikohen palë të reja interesi.

Regjistrimet e aktiviteteve të angazhimit të palëve të interesuara do të mbahen dhe do të përdoren për të përmirësuar angazhimin në të ardhmen.

5. Programi i Angazhimit të Palëve të Interesuara dhe Metodat e Konsultimit

5.1. Objektivat e Programit të Angazhimit të Palëve të Interesuara

Programi i Angazhimit të Palëve të Interesuara është hartuar për të siguruar komunikim sistematik, transparent dhe gjithëpërfshirës me palët e interesuara gjatë gjithë ciklit jetësor të Projektit. Programi synon:

- t'u ofrojë palëve të interesuara informacion në kohën e duhur, të lidhur me projektin dhe të kuptueshëm;
- të sigurojë që palët e interesuara të kenë mundësi të shprehin mendimet, shqetësimet dhe sugjerimet e tyre;
- të marrë në konsideratë komentet dhe kontributet e palëve të interesuara në planifikimin dhe zbatimin e Projektit, sipas rastit;
- të krijojë kanale të aksesueshme për komunikim dhe paraqitjen e ankesave;
- të ruajë marrëdhënie konstruktive me komunitetet e prekura nga Projekti, autoritetet dhe palët e tjera të interesuara.

Angazhimi i palëve të interesuara konsiderohet një proces i vazhdueshëm, i cili do të përshtatet në përputhje me fazat e Projektit dhe nevojat e palëve të interesuara.

5.2. Parimet e Angazhimit të Palëve të Interesuara

Aktivitetet e angazhimit do të kryhen në përputhje me parimet e përcaktuara në KMS 10 të BERZH-it dhe praktikatat e mira ndërkombëtare, duke përfshirë:

- Transparencën dhe llogaridhënien.
- Angazhimin e hershëm dhe të vazhdueshëm.
- Aksesueshmërinë e informacionit.
- Përfshirjen dhe mosdiskriminimin.
- Përshtatshmërinë kulturore të metodave të komunikimit.
- Reagimin ndaj shqetësimeve të palëve të interesuara.

- Dokumentimin dhe monitorimin e aktiviteteve të angazhimit.

Do t'i kushtohet vëmendje e veçantë sigurimit që grupet e cënueshme ose në disavantazh të kenë akses në informacion dhe mundësi për të marrë pjesë.

5.3. Konfidencialiteti, Mbrojtja nga Hakmarrja dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale

Projekti do të sigurojë që aktivitetet e angazhimit të palëve të interesuara dhe funksionimi i Mekanizmit për Trajtimin e Ankesave (MTA/GRM) të zhvillohen në mënyrë të tillë që të respektojnë konfidencialitetin, të mbrojnë të dhënat personale dhe të parandalojnë çdo formë detyrimi, frikësimi, diskriminimi ose hakmarrjeje, në përputhje me kërkesat e Politikës Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it, në veçanti me KMS 10.

Palët e interesuara do të kenë mundësi të paraqesin komente, të marrin pjesë në konsultime dhe të ngrenë ankesa pa pasur frikë nga pasoja negative. Projekti nuk do të tolerojë asnjë formë hakmarrjeje ndaj individëve ose grupeve që angazhohen me Projektin ose paraqesin ankesa në mirëbesim. Kur kërkohet, ankesat mund të paraqiten në mënyrë konfidenciale ose anonime. Identiteti i ankuesve do të mbrohet dhe do t'u bëhet i ditur vetëm personave të autorizuar që janë drejtpërdrejt përgjegjës për trajtimin e çështjes dhe vetëm në masën që kjo është e nevojshme për zgjidhjen e saj.

Të dhënat personale të mbledhura gjatë angazhimit të palëve të interesuara ose trajtimit të ankesave do të kufizohen në informacionin që është i nevojshëm për shqyrtimin dhe adresimin e çështjeve të ngritura. Këto të dhëna do të përpunohen në përputhje me legjislacionin kombëtar të zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me praktikën e mira ndërkombëtare. Informacioni do të ruhet në mënyrë të sigurt, aksesimi do të kufizohet vetëm për personelin e autorizuar dhe të dhënat personale nuk do të bëhen publike apo t'u transmetohen palëve të treta pa pëlqimin e personit përkatës, përveç rasteve kur kjo kërkohet nga ligji ose është e nevojshme për zgjidhjen e ankesës.

Të dhënat dhe evidencat lidhur me konsultimet dhe ankesat do të raportohen, sipas rastit, në formë të përmbledhur ose të anonimizuar. Pjesëmarrësit do të informohen për qëllimin e mbledhjes së të dhënave, si dhe për të drejtat e tyre në lidhje me konfidencialitetin dhe mënyrën e trajtimit të informacionit personal.

5.4. Qasja e Angazhimit të Palëve të Interesuara sipas Fazës së Projektit

Metodat dhe frekuenca e angazhimit do të ndryshojnë sipas fazës së Projektit.

5.4.1. Faza e Para-Ndërtimit

Gjatë fazave të planifikimit dhe marrjes së lejeve, aktivitetet e angazhimit do të fokusohen në:

- publikimin e informacionit të projektit dhe dokumentacionit mjedisor dhe social.
- konsultime me komunitetet dhe autoritetet lokale.
- identifikimin e shqetësimeve dhe pritshmërive të palëve të interesuara.
- krijimin e mekanizmave të ankesave dhe kanaleve të komunikimit.

Aktivitetet tipike të angazhimit do të përfshijnë:

- takime publike konsultimi.
- takime me autoritetet dhe institucionet lokale.

- publikimin e Përmbledhjes Joteknike dhe të PAPI-it.
- takime dypalëshe me palët kryesore të interesuara.

5.4.2. Faza e Ndërtimit

Gjatë ndërtimit, aktivitetet e angazhimit do të fokusohen në:

- Ofrimin e përditësimeve mbi aktivitetet dhe kalendarin e ndërtimit.
- Komunikimin e ndikimeve të mundshme të përkohshme, si trafiku apo zhurma.
- Mbajtjen e komunikimit të rregullt me autoritetet lokale.
- Menaxhimin e ankesave dhe reagimin ndaj shqetësimeve të palëve të interesuara.
- Monitorimin e çështjeve të shëndetit dhe sigurisë së komunitetit.

Aktivitetet e angazhimit mund të përfshijnë:

- Takime ose informime periodike me komunitetin.
- Njoftime dhe shpallje informacioni.
- Takime me autoritetet lokale dhe operatorët e infrastrukturës.
- Funksionimin e rregullt të mekanizmit të ankesave.

5.4.3. Faza e Operimit

Gjatë operimit, aktivitetet e angazhimit do të fokusohen në:

- Mbajtjen e kanaleve të komunikimit me palët e interesuara.
- Ofrimin e përditësimeve periodike mbi performancën e projektit, kur është e rëndësishme.
- Trajtimin e ankesave dhe pyetjeve.
- Raportimin e performancës mjedisore dhe sociale tek autoritetet dhe huadhënësit, sipas nevojës.

Aktivitetet e angazhimit mund të përfshijnë:

- Përditësime periodike informacioni.
- Takime me autoritetet lokale.
- Mbajtjen e mekanizmit të ankesave.
- Publikimin e rezultateve të monitorimit, kur është e përshtatshme.

5.5. Metodatat e Konsultimit

Do të përdoret një gamë metodash konsultimi dhe komunikimi, për të siguruar angazhim efektiv me grupe të ndryshme palësh të interesuara.

5.5.1. Takime të Fokusuara dhe Diskutime në Grupe të Vogla

Takime të synuara mund të zhvillohen me:

- Fermerët dhe përdoruesit e tokës.
- Grupet e cënueshme.
- Bizneset lokale.
- Përfaqësuesit e komunitetit.

Këto takime mundësojnë diskutim më të detajuar të shqetësimeve specifike.

5.5.2. Takime Dypalëshe

Takime dypalëshe do të zhvillohen me:

- Autoritetet lokale dhe kombëtare.
- Operatorët e infrastrukturës.
- Organet rregullatore.
- Kontraktorët dhe shërbimet publike.

Këto takime përdoren për koordinimin e çështjeve teknike dhe administrative.

5.6. Materialet e Publikimit të Informacionit

I gjithë informacioni për projektin Blue publikohet në faqen e internetit të projektit:

<https://www.spvblue.com/>

Materialet informative përfshijnë:

- Fletëpalosje dhe njoftime.
- Raporte VNMS / Përmbledhje Joteknike.
- Njoftime përmes autoriteteve lokale.
- Shpërndarje elektronike kur është e mundshme.

Informacioni do të jepet në format të qartë dhe të arritshëm.

Projekti do të zbatojë kanalet e mëposhtme për publikimin e informacionit:

- Tabelat e Njoftimeve në Vendndodhje: Përditësime mujore mbi aktivitetet e angazhimit. Përmbledhje e ankesave dhe zgjidhjeve.
- Publikim përmes Bashkisë. Informacion i shpërndarë me autoritetet lokale dhe zyrat e komunitetit
- Publikim Online (nëse zbatohet): Përditësime të projektit, Përmbledhje Joteknike (NTS), Të dhëna kontakti
- Takime me Komunitetin: Informime periodike publike

5.6.1. Komunikim Elektronik dhe në Distançë

Kur është e përshtatshme, komunikimi mund të përfshijë:

- Korrespondencë me email.
- Komunikim telefonik.

- Shpërndarje elektronike të dokumenteve.

Këto metoda mbështesin komunikimin e vazhdueshëm dhe aksesueshmërinë.

5.6.2. Vizita në Terren

Kur është e rëndësishme, mund të organizohen vizita në terren për:

- Autoritetet.
- Përfaqësuesit e komunitetit.
- Huadhënësit ose ekspertë të pavarur.

Vizitat në terren ndihmojnë në përmirësimin e transparencës dhe kuptimit të aktiviteteve të projektit.

5.7. Angazhimi me Grupet e Cenueshme

Mund të zbatohen masa specifike për të siguruar angazhim efektiv me grupet e cenueshme, duke përfshirë:

- Ofrimin e informacionit në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme.
- Organizimin e takimeve në grupe të vogla, kur është e përshtatshme.
- Sigurimin që vendet e konsultimit të jenë të arritshme.
- Koordinimin me autoritetet lokale ose përfaqësuesit e komunitetit për të identifikuar dhe arritur palët e interesuara të cenueshme.

5.8. Dokumentimi i Aktiviteteve të Angazhimit

Të gjitha aktivitetet e angazhimit me palët e interesuara duhet të dokumentohen zyrtarisht duke përdorur një format standard. Çdo evidencë e angazhimit duhet të përfshijë, të paktën, informacion mbi gjininë, kategorinë e palës së interesuar dhe vendndodhjen.

Kërkesat minimale për dokumentimin përfshijnë:

- datën dhe vendndodhjen;
- llojin e angazhimit (takim, konsultim, vënie në dispozicion të informacionit);
- grupin e palëve të interesuara;
- numrin e pjesëmarrësve, të ndarë sipas gjinisë;
- çështjet kryesore të ngritura;
- përgjigjet e dhëna;
- veprimet e dakordësuara.

Të gjitha evidencat do të regjistrohen në bazën e të dhënave të palëve të interesuara dhe do të përdoren për monitorimin e Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP/KPI).

5.9. Burimet dhe Përgjegjësitë

Përgjegjësia për zbatimin e programit të angazhimit të palëve të interesuara do t'i caktohet personelit të përcaktuar, zakonisht duke përfshirë:

- Menaxherin Mjedisor dhe Social.

- Zyrtarin e Ndërlidhjes me Komunitetin.
- Përfaqësuesit e kontraktorit gjatë ndërtimit.

Do të alokohen burime të mjaftueshme për të siguruar zbatimin efektiv të aktiviteteve të angazhimit.

5.10. Shqyrtimi dhe Përditësimi i Programit të Angazhimit

Programi i angazhimit të palëve të interesuara do të shqyrtohet periodikisht për të siguruar që mbetet i përshtatshëm dhe efektiv. Përditësimet mund të bëhen si përgjigje ndaj:

- Ndryshimeve në projektim ose kalendar të projektit.
- Identifikimit të palëve të reja të interesuara.
- Vërejtjeve të marra përmes konsultimeve ose ankesave.
- Rezultateve të monitorimit dhe mësimave të nxjerra.

Tabela 5 Kalendar i Publikimit të Informacionit

Informacioni që do të publikohet	Metoda	Vendndodhja	Frekuenca	Përgjegjësia
Përmbledhje e informacionit të projektit	Faqe interneti, tabela njoftimesh, fletëpalosje	Faqja e internetit e projektit, zyrat lokale të bashkisë, tabelat e njoftimeve të komunitetit	Përpara ndërtimit, e përditësuar sipas nevojës	CLO
Plani i Angazhimit të Palëve të Interesuara (PAPI)	Faqe interneti, kopje fizike	Faqja e internetit, zyrat e bashkisë	Njëherë, me përditësime sipas nevojës	Menaxheri Mjedisor dhe Social
Detajet e mekanizmit të ankesave	Postera, fletëpalosje, faqe interneti	Vendndodhja e projektit, komunitetet lokale, online	I vazhdueshëm	CLO
Përditësime ndërtimi	Tabela njoftimesh, përditësime në faqen e internetit	Vendndodhja e projektit dhe komunitetet në afërsi	Mujore	CLO / Kontraktori
Përmbledhje vjetore mjedisore dhe sociale	Faqe interneti	Online	Vjetore	Menaxheri Mjedisor dhe Social

6. Mekanizmat e Ankesave

6.1. Mekanizmi i Ankesave për Komunitetin

Projekti ka krijuar një Mekanizëm për Trajtimin e Ankesave të Komunitetit (GM/GRM), i cili siguron një proces formal dhe transparent përmes të cilit komunitetet e prekura, palët e interesuara dhe palët e tjera të interesuara mund të paraqesin shqetësime, ankesa ose sugjerime lidhur me aktivitetet e Projektit. Mekanizmi është hartuar në përputhje me kërkesat e Politikës Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it, në veçanti me KMS 10 për Angazhimin e Palëve të Interesuara, e cila kërkon krijimin e një mekanizmi të përshtatshëm me kontekstin kulturor, të aksesueshëm dhe transparent për pranimin dhe trajtimin e ankesave.

Ky mekanizëm është konceptuar për të plotësuar dhe jo për të zëvendësuar mjetet ekzistuese administrative ose gjyqësore të parashikuara nga legjislati shqiptar. Palët e interesuara ruajnë të drejtën që, në çdo fazë, t'u drejtohen autoriteteve lokale, institucioneve rregullatore ose gjykatave për zgjidhjen e çështjeve të tyre.

Mekanizmi për Trajtimin e Ankesave bazohet në parimet e aksesueshmërisë, transparencës, konfidencialitetit dhe përgjigjes në kohën e duhur. Për të siguruar që ankesat të mund të paraqiten pa pengesa, janë vënë në dispozicion disa kanale komunikimi, duke përfshirë, sipas rastit, mundësinë e paraqitjes së ankesave në mënyrë anonime ose konfidenciale. Projekti do të sigurojë që ankesat të mund të paraqiten dhe trajtohen pa frikë nga detyrimi, frikësimi apo hakmarrja.

Të gjitha ankesat do të regjistrohen, vlerësohen dhe trajtohen sipas një procedure të strukturuar, ndërsa rezultatet e shqyrtimit do t'u komunikohen ankuesve brenda afateve të përcaktuara. Informacioni përmbledhës mbi ankesat e paraqitura dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre do të përfshihet në monitorimin dhe raportimin periodik, duke respektuar kërkesat për konfidencialitetin.

Procesi që ndiqet për pranimin, trajtimin dhe mbylljen e ankesave paraqitet në figurën e mëposhtme.

Një Mekanizëm për Trajtimin e Ankesave (GM) është krijuar dhe aktualisht është në funksion për të gjitha Projektet Blue. Mekanizmi është bërë publik në faqen zyrtare të Projektit dhe mund të aksesohet në adresën: <https://www.spvblue.com/grievance-mechanism/n>

Ky mekanizëm do të zbatohet gjithashtu për Projektin BESS. Ai u ofron palëve të interesuara, përfshirë komunitetet e prekura dhe palët e tjera të interesuara, një proces transparent, të aksesueshëm dhe të strukturuar për paraqitjen e shqetësimeve, ankesave ose sugjerimeve që lidhen me aktivitetet e Projektit.

Mekanizmi për Trajtimin e Ankesave synon:

- t'u mundësojë palëve të interesuara të paraqesin shqetësimet e tyre në kohën e duhur dhe përmes mënyrave lehtësisht të aksesueshme;
- të sigurojë që ankesat të konfirmohen si të marra, të vlerësohen dhe të trajtohen brenda një afati të arsyeshëm;
- të përmirësojë performancën e Projektit përmes identifikimit dhe zgjidhjes së hershme të çështjeve;
- të forcojë besimin dhe komunikimin ndërmjet Projektit dhe palëve të interesuara;
- të parandalojë, për aq sa është e mundur, përshkallëzimin e konflikteve.

Mekanizmi për Trajtimin e Ankesave do të jetë i disponueshëm gjatë të gjitha fazave të Projektit, përfshirë fazën e ndërtimit dhe atë të operimit..

6.1.1. Fusha e Zbatimit të Mekanizmit të Ankesave

Mekanizmi i ankesave është i disponueshëm për:

- Komunitetet lokale.
- Përdoruesit e tokës dhe fermerët.
- Bizneset lokale.
- Organizatat e komunitetit.
- Palë të tjera të interesuara.

Ankesat mund të lidhen, ndër të tjera, me:

- Aktivitetet e ndërtimit.

- Çështjet e trafikut dhe aksesit.
- Zhurmën, pluhurin ose shqetësime të tjera.
- ndikimet mjedisore.
- shëndetin dhe sigurinë e komunitetit.
- sjelljen e punonjësve ose kontraktorëve.
- shqetësime të lidhura me punësimin, të ngritura nga anëtarë të komunitetit.

Ankesat e lidhura me punonjësit trajtohen përmes një mekanizmi të veçantë ankesash për punonjësit, të krijuar në përputhje me KMS 2 të BERZH-it.

6.1.2. Parimet e Mekanizmit të Ankesave

Mekanizmi për Trajtimin e Ankesave është hartuar në përputhje me parimet e mëposhtme:

- akses i lirë dhe pa pagesë për të gjitha palët e interesuara;
- transparencë dhe trajtim i drejtë;
- ruajtja e konfidencialitetit, kur kërkohet;
- mbrojtja e ankuesve nga çdo formë hakmarrjeje;
- përgjigje dhe zgjidhje brenda afateve të arsyeshme;
- dokumentim i qartë dhe mbajtje e rregullt e evidencave.

Palët e interesuara mund t'i paraqesin ankesat edhe në mënyrë anonime, nëse e preferojnë këtë mënyrë.

6.1.3. Paraqitja e Ankesave

Ankesat mund të paraqiten me gojë ose me shkrim. Kur një ankesë paraqitet me gojë, ajo mund t'i komunikohet drejtpërdrejt një specialisti të Projektit ose një përfaqësuesi të kompanisë. Përfaqësuesi që merr ankesën do ta dokumentojë atë duke plotësuar formularin standard të ankesës, duke siguruar që të regjistrohet i gjithë informacioni përkatës, dhe më pas do t'ia përcjellë personit të caktuar përgjegjës për menaxhimin e ankesave, për regjistrim, shqyrtim dhe ndjekje të mëtejshme.

Ankesat me shkrim mund të paraqiten duke plotësuar formularin e ankesës ose duke dhënë informacionin përkatës në formë të tjera të shkruara. Për të siguruar akses sa më të lehtë në mekanizëm, ankesat mund të paraqiten përmes disa kanaleve, duke përfshirë:

- postën elektronike (email);
- telefonin;
- formularët e ankesave të dorëzuar personalisht ose të dërguar me postë;
- paraqitjen e ankesave përmes autoriteteve lokale ose përfaqësuesve të komunitetit;
- ankesat verbale të regjistruara nga personeli i Projektit;
- kutitë e ankesave, aty ku parashikohet ose konsiderohet e përshtatshme.

Informacioni mbi Mekanizmin për Trajtimin e Ankesave (GM), përfshirë të dhënat e kontaktit, mënyrat e paraqitjes së ankesave dhe afatet për kthimin e përgjigjeve, është bërë publik dhe është përfshirë në materialet e konsultimit me palët e interesuara, me qëllim që palët e prekura të jenë të informuara për ekzistencën e mekanizmit dhe mënyrën se si mund ta përdorin atë.

Formulari i ankesës është i disponueshëm në faqen e internetit të Projektit dhe mund të shkarkohet, plotësohet dhe dorëzohet në përputhje me udhëzimet e dhëna në lidhjen e mëposhtme:

https://www.spvblue.com/wp-content/uploads/2023/03/Grievance-Form_FINALE-1.pdf

Formularët e plotësuar dhe paraqitje të tjera ankesash mund të dërgohen në:

Email: projectblue@blessedinvestment.com

Tel: +355 6883 48987

Tel: +355 4 22 58 326

6.1.4. Procedura e Trajtimin të Ankesave

Mekanizmi për Trajtimin e Ankesave ndjek një proces të strukturuar, me qëllim sigurimin e një qasjeje të njëtrajtshme, llogaridhënies dhe zgjidhjes në kohën e duhur të shqetësimeve të ngritura nga palët e interesuara. Për secilën fazë të procesit zbatohen afate të përcaktuara për kthimin e përgjigjes dhe trajtimin e çështjeve.

Përveç ankesave formale, Projekti merr edhe kërkesa të përgjithshme për informacion dhe komunikime të tjera nga palët e interesuara. Këto trajtohen veçmas nga Mekanizmi për Trajtimin e Ankesave, por sipas një procedure të përcaktuar për kthimin e përgjigjeve. Të gjitha komunikimet e jashtme që nuk përbëjnë ankesa konfirmohen si të marra brenda 2–3 ditëve pune, ndërsa një përgjigje e plotë jepet brenda 5–10 ditëve pune. Të gjitha këto komunikime regjistrohen në një regjistër të posaçëm komunikimi për qëllime monitorimi dhe ndjekjeje.

Performanca në lidhje me trajtimin e ankesave dhe komunikimin e jashtëm, përfshirë afatet e përgjigjes dhe përqindjen e çështjeve të zgjidhura, do të monitorohet përmes Treguesve Kryesorë të Performancës (KPI) të Projektit, siç paraqitet në **Error! Reference source not found.**

6.1.4.1. Hapi 1: Pranimi dhe Regjistrimi

Të gjitha ankesat regjistrohen në Regjistrin e Ankesave brenda 1–2 ditëve pune nga data e marrjes së tyre. Regjistri përfshin, të paktën, informacionin e mëposhtëm:

- datën e paraqitjes së ankesës;
- të dhënat e kontaktit të ankuesit, nëse janë dhënë;
- përshkrimin e ankesës;
- vendndodhjen dhe grupin e palës së interesuar;
- personin përgjegjës të caktuar për trajtimin e ankesës.

Marrja e ankesës i konfirmohet ankuesit brenda afatit të përcaktuar.

6.1.4.2. Hapi 2: Konfirmimi i Marrjes së Ankesës

Ankuesi merr konfirmimin e pranimit të ankesës brenda afërsisht 3–5 ditëve pune. Në këtë konfirmim bëhet e ditur se ankesa është marrë dhe është në proces shqyrtimi.

6.1.4.3. Hapi 3: Vlerësimi dhe Shqyrtimi

Ekipi i Projektit fillon vlerësimin e ankesës brenda 5 ditëve pune nga marrja e saj. Procesi përfshin:

- shqyrtimin e ankesës;

- përcaktimin e natyrës dhe rëndësisë së çështjes së ngritur;
- caktimin e përgjegjësisë për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes;
- konsultimin, sipas nevojës, me kontraktorët ose specialistët përkatës.

Kur konsiderohet e nevojshme, mund të kryhen vizita në terren ose takime me ankuesin për të verifikuar dhe sqaruar çështjen e ngritur.

6.1.4.4. Hapi 4: Përgjigjja dhe Zgjidhja

Përgjigjja i jepet ankuesit brenda një afati të arsyeshëm, zakonisht brenda 15–30 ditëve pune nga data e marrjes së ankesës, në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të çështjes.

Përgjigjja përfshin:

- rezultatet e shqyrtimit;
- masat korrigjuese të propozuara, kur është e zbatueshme;
- afatin e parashikuar për zbatimin e këtyre masave.

6.1.4.5. Hapi 5: Mbyllja e Ankesës

Një ankesë konsiderohet e mbyllur kur:

- ankuesi pranon zgjidhjen e propozuar; ose
- janë ndërmarrë dhe dokumentuar të gjitha përpjekjet e arsyeshme për zgjidhjen e çështjes.

Mbyllja e ankesës konfirmohet brenda 5 ditëve pune nga arritja e marrëveshjes ose përfundimi i veprimit të fundit të nevojshëm. Të dhënat mbi ankesat, procesin e trajtimit dhe zgjidhjen e tyre ruhen në Regjistrin e Ankesave.

6.1.4.6. Hapi 6: Përshkallëzimi i Ankesës

Nëse ankuesi nuk është i kënaqur me zgjidhjen e propozuar, ankesa mund të përshkallëzohet brenda 5–10 ditëve pune nga marrja e përgjigjes. Në varësi të rastit, ankesa mund:

- të rishqyrtohet nga niveli i lartë drejtues i Projektit;
- t'u referohet autoriteteve përkatëse, kur është e përshtatshme;
- të ndiqet nëpërmjet procedurave gjyqësore ose administrative jashtë mekanizmit të Projektit.

Përdorimi i Mekanizmit të Projektit për Trajtimin e Ankesave nuk kufizon dhe nuk pengon të drejtën e ankuesit për të përdorur mjete të tjera administrative ose ligjore të disponueshme.

6.1.5. Regjistri dhe Monitorimi i Ankesave

Mbahet një Regjistër i Centralizuar i Ankesave për regjistrimin dhe ndjekjen sistematike, transparente dhe të strukturuar të të gjitha ankesave të komunitetit. Regjistri përmban, të paktën, informacionin e mëposhtëm:

- numrin unik të referencës;
- datën e marrjes së ankesës;
- vendndodhjen e ankuesit (fshati/komuniteti);

- kategorinë e palës së interesuar (p.sh. banor vendas, përdorues i tokës, biznes, pjesëtar i një grupi vulnerabël);
- gjininë e ankuesit, kur kjo e dhënë është bërë e ditur;
- kategorinë/llojin e ankesës;
- përshkrimin e çështjes së ngritur;
- masat ose veprimet e ndërmarra;
- datën e zgjidhjes së ankesës;
- statusin e ankesës (e hapur, në shqyrtim, e mbyllur).

Të dhënat mbi ankesat rishikohen periodikisht për të identifikuar çështjet që përsëriten, për të analizuar tendencat dhe për të përmirësuar praktikën e angazhimit me palët e interesuara.

Projekti kryen monitorim dhe analizë mujore të të dhënave mbi ankesat, duke përfshirë:

- numrin e përgjithshëm të ankesave të marra;
- përqindjen e ankesave të zgjidhura (%);
- kohën mesatare të nevojshme për zgjidhjen e ankesave;
- shpërndarjen e ankesave sipas kategorive të palëve të interesuara;
- shpërndarjen e ankesave sipas gjinisë;
- llojet e ankesave të ngritura nga grupe të ndryshme të palëve të interesuara.

Kjo analizë përdoret për:

- të identifikuar shqetësimet e komunitetit që përsëriten ose që mund të kenë karakter sistematik;
- të vlerësuar nëse grupe të caktuara, përfshirë gratë ose palët vulnerabël të interesuara, përballen me pengesa në aksesin dhe përdorimin e Mekanizmit për Trajtimin e Ankesave;
- të përmirësuar komunikimin, strategjitë e angazhimit me palët e interesuara dhe masat e Projektit për parandalimin ose zbutjen e ndikimeve.

Kur identifikohen mangësi, pengesa ose tendenca të përsëritura, zbatohen masa korrigjuese, të cilat mund të përfshijnë komunikim dhe angazhim të drejtpërdrejtë me grupet përkatëse, përmirësimin e vënies në dispozicion të informacionit dhe përshtatjen e Mekanizmit për Trajtimin e Ankesave, me qëllim sigurimin e aksesit të barabartë për të gjitha palët e interesuara.

6.1.6. Komunikimi dhe Informimi mbi Mekanizmin për Trajtimin e Ankesave

Informacioni mbi Mekanizmin për Trajtimin e Ankesave bëhet i disponueshëm përmes:

- takimeve të konsultimit publik;
- fletëpalosjeve informuese;
- zyrave të autoriteteve lokale;
- materialeve të komunikimit të Projektit.

Palët e interesuara janë informuar dhe do të vijojnë të informohen në lidhje me:

- mënyrën e paraqitjes së ankesave;
- afatet e pritshme për kthimin e përgjigjeve;
- masat dhe kërkesat për ruajtjen e konfidencialitetit.

6.2. Mekanizmi i Ankesave të Punonjësve (KMS2)

Projekti ka krijuar një Mekanizëm për Trajtimin e Ankesave të Punonjësve (WGM), në përputhje me Kërkesën Mjedisore dhe Sociale 2 të BERZH-it (KMS 2) për Punën dhe Kushtet e Punës.

Ky mekanizëm përshkruhet në mënyrë të detajuar në Procedurat e Menaxhimit të Punës (LMP) dhe në procedurat e Burimeve Njerëzore (BNj), dhe zbatohet për të gjitha kategoritë e punonjësve, përfshirë punonjësit e drejtpërdrejtë, punonjësit e kontraktorëve dhe nënkontraktorëve, si dhe punonjësit e përfshirë në zinxhirin e furnizimit.

Të gjitha ankesat e punonjësve do të regjistrohen në një regjistr të posaçëm. Marrja e ankesës do të konfirmohet brenda 2–3 ditëve pune, ndërsa përgjigja do të jepet brenda 5–10 ditëve pune. Rastet më komplekse mund të kërkojnë kohë shtesë për shqyrtim; në këto raste, punonjësi do të informohet për afatin e parashikuar për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesës.

Kontraktori do të mbajë përgjegjësinë kryesore për zbatimin e Mekanizmit për Trajtimin e Ankesave të Punonjësve për personelin e kontraktuar, ndërsa Projekti do të mbikëqyrë përputhshmërinë me kërkesat përkatëse dhe do të monitorojë performancën përmes raportimit të rregullt. Treguesit Kryesorë të Performancës (KPI), si numri i ankesave të marra dhe koha e nevojshme për zgjidhjen e tyre, do të monitorohen dhe do të përfshihen në raportimin e brendshëm dhe të jashtëm.

Mekanizmi për Trajtimin e Ankesave të Punonjësve përfshihet gjithashtu në këtë Plan të Angazhimit të Palëve të Interesuara (PAPI), me qëllim sigurimin e harmonizimit ndërmjet proceseve të brendshme dhe të jashtme për trajtimin e ankesave.

Mekanizmi është në funksion dhe mund të aksesohet përmes disa kanaleve, duke përfshirë kutitë e ankesave, raportimin e drejtpërdrejtë tek Oficeri për Marrëdhëniet me Komunitetin (CLO), si dhe komunikimin përmes telefonit dhe postës elektronike.

6.2.1. Fusha dhe Zbatueshmëria

Mekanizmi i Ankesave për Punonjësit (MAP/WGM) është krijuar në përputhje me Kërkesën Mjedisore dhe Sociale 2 të BERZH-it, Puna dhe Kushtet e Punës. Mekanizmi është i arritshëm për të gjitha kategoritë e punonjësve të angazhuar në aktivitete të lidhura me Projektin.

WGM zbatohet për:

- Punonjësit e drejtpërdrejtë të punësuar nga Projekti
- Punonjësit e kontraktorit
- Punonjësit e nënkontraktorëve (të gjitha nivelet)
- Punonjësit e zinxhirit të furnizimit të lidhur me furnitorët kryesorë
- Asnjë kategori punonjësish nuk përjashtohet nga aksesimi në mekanizmin e ankesave.

6.2.2. Qëllimi

Mekanizmi i Ankesave të Punonjësve ofron një proces formal, transparent dhe konfidencial për punonjësit, që të ngrenë shqetësime, ankesa ose vërejtje lidhur me:

- Kushtet e punës
- Shëndetin dhe sigurinë në punë
- Termat dhe kushtet e punësimit
- Ngacmimin, diskriminimin ose trajtimin e padrejtë
- Çdo çështje tjetër të lidhur me vendin e punës

6.2.3. Parimet Kryesore

Mekanizmi është projektuar në përputhje me parimet e mëposhtme:

- Aksesueshmëria: I disponueshëm për të gjithë punonjësit, pavarësisht nga lloji i punësimit
- Konfidencialiteti: Të gjitha ankesat trajtohen me konfidencialitetin e duhur
